



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:205478

Datë: 20.04.2021

Numri i dokumentit: 01711263

PS.nr. 15/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI SPECIAL, në përbërje të Trupit Gjykses, gjyqtarëve Arben Hoti-kryetar, Albina Shabani - Rama dhe Shadije Gërguri-anëtare, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shqipe Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit Z. Dj. i akuzuar se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Krime të Luftës Kundër Popullatës Civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, lidhur me nenin 3 të përbashkët për Konventat e Gjenevës të dt.12 Gusht 1949 dhe nenin 4 të Protokollit 2 të datës 8 Qershor 1977 shtojcë e Konventave të Gjenevës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.23/2018 të dt.31.05.2019 dhe aktakuzës së ndryshuar dhe zgjeruar PPS.nr.23/2018 të dt.08.01.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës dt.04.02.2021, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori Special – Habibe Salih, i pandehuri Z. Dj. mbrojtësi i të pandehurit av. Lj. P. sipas autorizimit, përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. K. K. të dëmtuarit L. Z., M. Z., V. B., F. M., A. N., dhe L. H., si dhe përkthyesi i gjykatës I. S. nga gjuha shqipe në serbe dhe anasjelltas, pas seancës për këshillim dhe votim me dt.11.02.2021, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

Z. DJ., i biri i M. dhe N. e gjinisë M., i lindur më data e lindjes..., rr.”...”, ..., Komuna P., me vendbanim aktual në Republikën e Serbisë – Beograd rr.”...” ..., i martuar, me profesion ekonomist i diplomuar, serb, shtetas i Republikës së Kosovës dhe shtetas i Serbisë. Gjendet në paraburgim nga data ...,

ËSHTË FAJTOR

- I. Gjatë muajit Mars të vitit ..., gjegjësisht me dt...., në lagjen “...” që tani quhet “...” në P., i pandehuri Z. Dj. në bashkëkryerje me një grup të forcave të armatosura serbe (policisë rezervë, ushtrisë dhe forcave para ushtarake), të veshur me uniforma, me qëllim të shkakimit të vuajtjeve të mëdha dhe cenimit të integritetit trupor dhe shëndetit, përmes aplikimit të masave të frikësimit dhe terrorit ndaj popullatës së pa armatosur dhe pambrojtur civile, kanë urdhëruar zhvendosjen e popullatës civile shqiptare të cilët nuk kanë marrë pjesë drejtpërdrejtë në konflikt, i pandehuri së bashku me persona të tjerë hyjnë dhunshëm në shtëpitë e qytetareve shqiptar duke kërkuar

personin e quajtur L. i cili atë ditë nuk kishte qenë në shtëpinë e tij, pastaj hyjnë në shtëpinë e të dëmtuarit A. N. duke shtënë me armë automatike në ajër, dhe duke i urdhëruar që dhunshëm të dalin nga shtëpia e tij në afat kohor prej 5 minutave duke iu drejtuar me fjalët “shqiptar krejtve duhet me ju vra, shkoni për Shqipëri” në atë mënyrë që e kanë detyruar të dëmtuarin A. dhe qytetaret e tjerë shqiptar të largohen nga shtëpitë e tyre duke i ndarë në drejtime të kundërta, disa anëtar të familjes në drejtim të Shqipërisë ndërsa pjesa tjetër në drejtim të Malit të Zi.

II. Gjate muajit ..., të vitit ..., konkretisht me datë ..., në lagjen “...” në P., i pandehuri Z. Dj. në bashkëkryerje me një grup të forcave të armatosura serbe (policisë rezervë, ushtrisë dhe forcave para ushtarake), të veshur në uniforma, u kanë shkaktuar vuajtje të mëdha, si dhe cenim të integritetit trupor dhe shëndetit viktimave, kanë aplikuar masa të frikësimit ndaj popullatës së pambrojtur civile të nacionalitetit shqiptarë, kanë kryer vrasje, plaçkitje dhe kanë urdhëruar zhvendosjen e popullatës civile shqiptare nga shtëpitë e tyre, për shkaqe që lidhen me konfliktin e armatosur, e cila popullatë civile ishte e pambrojtur dhe e paarmatosur dhe e cila nuk ka marrë pjesë në luftime, ashtu që deri sa familja e të dëmtuarit L. H. konkretisht vëllau i tij B. me familjen e tij dhe dy fëmijët e L. kanë qenë duke u larguar dhunshëm nga shtëpia e tyre, pasi që janë futur në veturën “...” ngjyrë portokalli, kanë tentuar që t’i ndalin duke i drejtuar me fjalët ndalu ndalu “stani stani”, me qëllim që t’i privojnë nga jeta kanë shtënë me armë në drejtim të tyre me ç ‘rast me katër plumba është goditur vetura ku ishin edhe dy fëmijët e mitur të dëmtuarit L. H. dhe atë djali i madh i moshës nëntë vjeçar duke i mbajtur dorën vëllait të tij tre vjeçar me qëllim që t’a mbrojë ku me këtë rast goditet në dorën e djathtë, ndërsa djali i vogël i cili ishte mbrapa shpinës së tij është goditur me një plumb me ç ‘rast i janë shkaktuar lëndime trupore.

Pjesëtarët e grupit të armatosur në mesin e të cilëve ishte edhe i pandehuri Z. Dj. kanë shtënë fillimisht në drejtim të dëmtuarit L., pastaj kanë hyrë në shtëpinë e tij duke e plaçkitur dhe marrë të gjitha të hollat dhe e kanë detyruar bashke me bashkëshorten e tij dhe kunatën të largohen nga shtëpitë e tyre. Më pas ky grup kishte shtënë me armë në drejtim të shtëpisë së të dëmtuarit F. H. me qëllim që t’a privoj nga jeta, i cili kishte qenë i fshehur në kulmin e shtëpisë së tij, ndërsa në momentin që kishin kuptuar se ishte Brenda e gjithë familja njeri nga personat e armatosur me një shkrepës kishte ndezur një lloj bombe duke shkaktuar zjarre në drunjtë që ishin në oborr, nga i cili zjarre kishte filluar të digjej edhe shtëpia e të dëmtuarit F. H., por që pasi që i pandehuri me bashkë kryesit e tjerë janë larguar, i dëmtuari F. dhe familja e tij kanë arritur që t’a ndalin zjarrin.

Pjesëtarët e grupit të armatosur të nacionalitetit serb në mesin e të cilëve ishte edhe i pandehuri Z. Dj. më pas kanë vazhduar largimin e popullatës së paarmatosur civile shqiptare nga shtëpitë e tyre duke hyrë dhunshëm në shtëpinë e H. Z. i cili ishte së bashku me familjen e tij dhe familjen e vëllait të tij S. dhe familjen e të dëmtuarit Sh. K., fillimisht i ndajnë burrat nga gratë dhe fëmijët, kanë rrahur të dëmtuarin Sh., dhe i kanë detyruar me dhunë të dëmtuarin Sh. dhe tani të ndjerin S. që t’ua dorëzojnë të gjitha parat që i kishin dhe arin e familjes.

Një person i forcave të armatosura ka kërkuar para edhe tani të ndjerit H. i cili ja kthen se t’i ka dhënë S., personi i uniformuar i ishte drejtuar H. me fjalët “unë ty po të njoh” dhe në ato momente e kishte goditur H. me një plumb nga arma automatike, i cili nga goditja ishte rrezuar në toke duke kërkuar ndihmë dhe duke thënë “fëmija fëmija”. Pasi që i dëmtuari Sh. dhe S. ishin detyruar përsëri që të dalin jashtë dhe të marrin paratë dhe arin nga familjarët e tyre, kur kthehet brenda në shtëpi Sh., personi që e kishte goditur H. e cili ishte gjallë deri në ato momente dhe në një pozicion pak të ngritur duke u mbajtur për bërryla të dorës, e godet edhe një herë në pjesën e brinjëve dhe nga kjo goditje i ndjeri H. është shtrirë për toke tërësisht, ndërsa S. dhe Sh.

detyrohen t'a lëshojnë shtëpinë dhe pasi dalin në rrugë e takojnë B. B. tani të ndjerë, të cilin e kishte marrë me dhunë nga shtëpia e tij i pandehuri Z. Dj., dhe i kishin urdhëruar që të tre të vazhdojnë rrugën tatëpjetë, dhe me te arritur tek shtëpia e A. M. e cila ishte afërsisht 70 metra larg nga vendi ku është vranë H., njëri nga pjesëtarët e grupit të armatosur i kanë ndalur që të tre, duke urdhëruar S. dhe B. që të hynë brenda në oborrin e shtëpisë së A. M., diku 4-5 metra, ndërkohe që dyert e mëdha të oborrit të shtëpisë ishin të hapura, ndërsa të dëmtuarin Sh. e kishin lënë në rrugë duke qëndruar. Pastaj një pjesëtar i grupit ka shtënë me armë automatike "Kallashnikov" duke e goditur S. ne fytyrë me rrafall, pastaj edhe bashkimin e ka goditur me rrafall në gjoks duke i lënë që të dy të vdekur, ndërsa Shabanin e urdhëron "vrapo çka po pret" dhe i dëmtuari Sh. largohet.

Deri sa i dëmtuari Sh. K. kishte vazhduar rrugën në drejtimin në të cilin e kishin urdhëruar kishte takuar R. M. tani i ndjerë i cili ishte me një karrocë në dorë, kurse i dëmtuari Sh. nga mbrapa ka dëgjuar hapat duke ardhur një person i armatosur dhe uni formuar i cili e kishte goditur me breshëri automatiku tani të ndjerin R. M. dhe e kishte lënë të vdekur. Pastaj Sh. vazhdon rrugën dhe vendoset në fillim në shtëpinë e babait të tij, për tu larguar të nesërmen në Mal të Zi.

- Me këtë i pandehuri Z. Dj. në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Krime të Luftës kundër popullatës civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, lidhur me nenin 3 të përbashkët për Konventat e Gjenevës të dt.12 Gusht 1949 dhe nenin 4 të Protokollit 2 të datës 8 Qershor të dt.1977 shtojcë e Konventave të Gjenevës.

Andaj Gjykata në mbështetje të dispozitave ligjore dhe atë nenit 365 të KPPRK-së dhe neneve 22, 33, 34, 38, dhe 41, dhe nenit 142 të Ligjit Penal të RSFJ-së të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME BURGIM

Të pandehurit **Z. Dj.** i shqipton dënim burgimi në kohëzgjatje prej **12 (dymbëdhjetë) vite** me të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e qëndrimit në paraburgim.

Konform nenit 367 par. 2 të pandehurit i vazhdohet paraburgimi deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi por jo më shumë se koha e shqiptimit të këtij dënimi.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 700 (shtatëqind) euro në afatin prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit V. B., L. Z., M. Z., Sh. K., M. Xh., F. M., L. H., F. H. dhe A. N. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m i

I. Historiku i procedurës

1.1. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka paraqitur aktakuzën PPS.nr 23/2018 me dt. 31.05.2019 kundër të pandehurit Z. Dj. për shkak të veprës penale Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës, që ndiqet sipas nenit 152 par.1 të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, Krimet e Luftës në shkelje të rëndë

të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar që ndiqen sipas nenit 153 par 1 nën par 2.1, 2.2, 2.5, 2.8, 2.13 dhe nenit 3 të KPK-së.

1.2. Duke vepruar në këtë çështje gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, ku fillimisht të pandehurit i është lexuar aktakuza, ndërsa kryetari i trupit gjykues pasi u bind se i pandehuri e ka kuptuar përmbajtjen e akuzës, të njëjtit i dha mundësia të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

1.3. I pandehuri Z. Dj., është deklaruar i pafajshëm për veprën penale me të cilën e ka ngarkuar akuza.

II. Shqyrtimi gjyqësor dhe deklaratimet e palëve

Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën hyrëse të palëve¹. Prokurori i shtetit dhe palët tjera në procedurë, kanë përmbledhur provat që mbështesin rastin dhe kërkesat e tyre, ndërsa më pastaj në procedurën e provave shqyrtimi ka vazhduar me dëshminë e dëshmitarëve.

2.1. Dëshmitarja – e dëmtuara M. Z. në dëshminë e saj dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: i kujtohet data 29.03.1999 shumë mirë ngase ka qenë ditëlindja e djalit të saj D. i cili kishte mbushur 5 vjet, në shtëpinë e tyre kishin qenë burri i saj, me fëmijët, kunati H. me gruan L. me fëmijët, si dhe Sh. K. me gruan dhe fëmijët. Ky i fundit ishte bashkangjitur me arsyen se është frikuar që të qëndroj vetëm. Momentin kur kanë dëgjuar krisma në mahallë që të gjithë kanë shkuar në bodrum për tu fshehur pasi që nuk kishin rrugëdalje tjetër. Aty kanë qëndruar afër 2 orë, para se me shkuar në bodrum kanë dëgjuar një krismë, ku ishte dëgjuar edhe dera e hyrjes ngase ka hy dikush brenda dhe në gjuhën serbe ka bërtit dikush “e dimë se jeni në bodrum dilni të gjithë se do t’ju kallim të gjallë” me të dëgjuar këto fjalë e dëmtuara kishte dalë e para në korridor ku kishte parë tre ushtar të veshur, me fytyra të ngjyrosura me ngjyrë hiri dhe të gjelbër, duke theksuar se kanë pas edhe diçka në kokë por nuk i kujtohej mirë se a kanë qenë shamia apo kapele dhe se kanë mundur edhe anëtarët e tjerë me dalë në korridor dhe i kanë qitur jashtë. Pasi që i kanë qitur krejt jashtë e kanë ndalur Sh. K. në korridor, ku të tjerët i kanë rreshtuar te dera e oborrit brenda në oborr dhe kanë gjuajtur nëpër këmbë të tyre me alltia ka deklaruar dëshmitarja, gjatë asaj kohe e kanë thirrur H. për ta dërguar brenda në korridor të shtëpisë së tyre, gjersa ai e kishte djalin e tij në dorë (gryk) i kishin bërtitur “lëshoje fëmijën”, ndërsa dëshmitares nuk i kujtohet sa ka qëndruar brenda, por nga ai moment nuk e ka parë më. Pastaj e kishin thirrur burrin e saj S. dhe të tjerët i kanë qitur jashtë afër shtëpisë së V., gjersa jashtë kishte pas polic të rreshtuar. Pak më vonë e ka parë burrin e vet që ka dal jashtë dhe ja ka kërkuar 1000 marka që i kishte pas dëshmitarja me veti, me të marrë paratë burri saj ka hyrë shpejt brenda. Më pas i kishin dërguar deri te shtëpia e A. M., duke vazhduar rrugës dëshmitarja e ka kthyer kokën mbrapa, e ka parë burrin e saj që po vjen së bashku me Sh., të njëjtit kanë shkuar deri te shtëpia e A. dhe aty ka parë që janë ndal, nga ky moment nuk i ka parë më, sepse i kanë dëbuar duke ju thënë shkoni drejtë. Më pas kishin vazhduar nga qyteti deri te shtëpia e babait të Sh., aty kanë qëndruar një natë me gjithë fëmijët, të nesërmen janë nisur për R.. Gjatë kohës që kanë qëndruar në R. nuk ka ditur asgjë për burrin e vet dhe kunatin e saj sepse askush nuk kishte marrë guxim ti njoftonte diçka. Pas R. kishin vazhduar për në U. Me tu kthyer nga U. kanë kuptuar se ata janë vlarë, dhe më tej ka shtuar se nuk janë kthyer te shtëpitë e veta sepse ato ishin djegur. Me tu kthyer në Pejë askush si ka thënë diçka të saktë vetëm është dëgjuar nga populli se ky ka qenë, ai ka qenë dhe është dëgjuar emri i Z. Dëshmitarja ka dëshmuar se nga

¹ Shih fjala hyrëse e palëve

kunati i saj nga Amerika e ka kuptuar që burri i saj ka vdekur, se kufoma deri në vitin 2005 nuk është varrosur ato kanë qëndruar në Serbi diku dhe në vitin 2005 janë informuar se ato janë gjetur dhe janë sjellë në Kosovë.

Dëshmitarja gjatë dëshmisë së saj ka dëshmuar edhe disa detaje duke theksuar se vajza e madhe në atë kohë ka qenë rreth 16 vjet, vajza e dytë 13 vjeçare, djali 10 vite dhe djali tjetër 5 vjet. Se momentin që i kanë nxjerrë nga shtëpia përveç familjes K. dhe familjes së saj Z. i ka parë edhe V. edhe M. të cilët ishin me dy ushtar që e kanë sjell nga shtëpia rrugës për tek ata, se vajza e saj e ka kapur për trupi dhe e njëjta ka qarë shumë. Aty ka qenë edhe gruaja e M. e quajtur R. dhe vajza e saj H. Kur kanë dalë në lagje ka qenë edhe N. H., Sh. H. – gruaja e tij, djali i madh Fuad, i dyti B. sepse ata ishin së bashku me dëshmitaren kur i kanë dëbuar të gjithë. Dëshmitarja gjithashtu ka theksuar se ata që i kanë dëbuar kanë pas fytyrat e ngjyrosura me vija ngjyrë hiri, të ngjyrosura horizontalisht prej hundës në drejtim të mollëzave. Momentin kur i kanë qitur jashtë për me i dëbuar, dëshmitarja ka treguar se aty jashtë kanë qenë tridhjetë ushtar kanë qenë të veshur, kanë pas uniforma ngjyrë hiri në të gjelbër.

2.2. Dëshmitarja – e dëmtuara L. Z., në dëshminë e saj dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: i kujtohet data 29.03.1999 atë ditë ishin në shtëpinë e saj ku ishin strehuar në bodrumin e shtëpisë me kunatin dhe fëmijët e tij, dëshmitarja L. me fëmijët dhe burrin, dhe Sh. K. me familjen e vet. Atë ditë janë bashkuar se kanë pas frikë nga forcat serbe dhe kanë qëndruar aty. Në një moment kanë dëgjuar se forcat serbe kanë hyrë në oborrin e shtëpisë së tyre atë ditë, duke e thyer derën e shtëpisë e duke hyrë në korridor dhe duke folur në gjuhën e tyre “dilni se e dimë që jeni këtu”. Dëshmitarja thekson se kanë dalë në korridor dhe aty kanë qenë policia dhe të gjithë i kanë qitur jashtë ku kishte pasur polic tjerë aty që po i prisnin, i kishin ofruar te oborri i shtëpisë duke i renditur dhe tërë kohën duke gjuajtur me armë zjarri, në drejtim te poshtë e lartë. Dëshmitarja shton se ajo e ka pas vajzën në gryk ndërsa burri saj e ka pas djalin, ku njëri nga policët e ka thirrur burrin e vet në gjuhën e tyre duke i thënë “eja këtu” dhe ai është nisur rrugës duke shkuar te polici i ka thënë lëshoje djalin dhe djali nuk donte të largohej nga babai i vet, policia përsëri i ka thënë lëshoje djalin se ju vras të dyve, ku fëmija përsëri nuk ka dashur të largohet nga babai i tij duke e kapur për këmbë, fëmija i kishte tre vjet në atë kohë dhe dikur djali është frikuar shumë dhe duke u dridhur ka shkuar tek dëshmitarja. Sipas dëshmitares polici që i ka thënë lësho djalin i ka pas vetullat e zeza dhe ka qenë shumë agresiv, se ata tërë kohën kanë gjuajtur dhe kanë thënë “keni dashtë NATO dhe NATO ju ka dal”. Dëshmitarja më tej ka dëshmuar se ata gjithë kohës kanë shkuar se kush po bjerë për tokë nga gjuajtja e plumbave, ata kanë qenë me fytyra të kamufluara me ngjyra dhe fëmijët ishin të shqetësuar, se H. e kishin futur brenda në korridor të shtëpisë dhe se prej atëherë dëshmitarja nuk e ka parë më burrin e saj. Dëshmitarja ka shtuar se të tjerët i kishin qitur jashtë oborrit te muri i komshiut dhe i kanë renditur një nga një familjarët, se aty ka pas edhe familje tjera por nuk i është kujtuar dëshmitares saktësisht kush ka qenë pasi që ato momente ka qenë shumë e hutuar duke u marrë me fëmijët dhe duke i pajtuar. E njëjta shton se e ka parë Sh. – kunatin kur ka dal jashtë dhe i ka kërkuar gruas së tij para dhe ajo paratë i ka pas në trenerka, se nuk ka mundur me i hekë, dhe kunati me gjithë trenerka i ka marr paratë dhe ka hy brenda. Dëshmitarja shton se pastaj kanë vazhduar me ecur rrugës lartë në drejtim të shtëpisë të A. M., pastaj te një rrugë qarkulluese – kryesore. Dëshmitarja ka theksuar se e ka parë S. dhe Sh. që i ka ndal policia afër shtëpisë së A. dhe se ka qenë momenti i fundit që i ka parë ata të dy. Më pastaj kanë shkuar te prindërit e A. ku kanë fjetur një natë dhe të nesërmen kanë shkuar për Mal të Zi, atje kane qëndruar derisa kanë hyrë forcat e KFOR-it në Kosovë. Se nuk e ka ditë saktësisht që është vrarë burri i saj, por kur ka dal në U. te pazari me blere ilaçe për vajzën një person i kishte thënë a ta kanë vrarë burrin, duke shtuar e se ky person që i kishte treguar ka qenë nga P. por që me saktësi tani nuk i kujtohet se cili ka qenë, por që i njëjti i kishte thënë se njëfarë Z. e ka vrarë. Se e ka kuptuar çka ka ndodhur

kur është kthyer në P. nga kunati i saj M. Z. Trupat e familjareve të tyre i kanë gjetur në vitin 2005 në B., i kanë marrë në M. dhe prej aty në P. ku është bërë ri varrimin. Se policët që i ka parë në ditën kritike kanë qenë shumë por me numër nuk e din, sepse sipas dëshmitares e njëjta ishte e hutuar shumë dhe tërë kohës kanë shtënë si në oborr si jashtë, gjithashtu edhe brenda kanë gjuajtur sa kanë mundur ka shtuar dëshmitarja. Se në momentin kur janë kthyer nga Mali i Zi shtëpinë e kanë gjetur të djegur edhe krejt shtëpitë kanë qenë të djegura dhe të pa banuara.

Në pyetjet e përfaqësuesit të palëve të dëmtuara dëshmitarja ka dhënë detaje tjera lidhur me ditën kritike, duke shtuar se kur i kanë nxjerr jashtë përveç familjes të saj Z. dhe K. ka pasur edhe të tjerë por nuk e di kush ka qenë sepse ka qenë e trulllosur, duke i mbajtur dy fëmijët e saj në gryk të cilët e kërkonin babain e tyre dhe prej frikës që po i vrasin nuk ka shikuar saktësisht kush është, te shtëpia nuk kemi pas mundësi as të kthehemi se tërë kohës na thonin ikni ikni se do ju vrasim, ka deklaruar dëshmitarja. Përballë shtëpisë së saj është edhe shtëpia e V., e cila ishte afër tyre tërë kohën duke qajtur për vëllain e saj sepse ja kishin marrë. Momentin kur i kanë nxjerr jashtë ka pasur forca shumë të armatosura dhe pak më larg se shtëpia e A. gjendet shtëpia e F. H., në anën e majtë ka qenë shtëpia e A. dhe në të djathtë e F., se tërë kohës ka pas edhe lëvizje të ushtarëve në lagje. Dëshmitarja thekson se para dëshmisë së dhënë në gjykatë ka dhënë dëshmi në polici dhe prokurori dhe ka deklaruar se mbetet pranë tyre.

2.3. Dëshmitarja – e dëmtuara V. B., në dëshminë e saj dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: i kujtohet data 29.03.1999, ka qenë dita dytë e bajramit, orën nuk e ka ditur sa është saktësisht, atë ditë në shtëpi ishte me babin, nënën dhe vëllain, se nëna e saj ka qene e sëmur nga diabeti ku kanë shkuar për të matur sheqerin në gjak, e njëjta kishte mbetur vetëm me vëllaun e saj në shtëpi, se vëllau i saj B. B. kishte dal në mahallen tjetër në komshi, ku edhe vet dëshmitarja pastaj kishte dal deri në gjysmë të lagjes dhe aty e ka kthyer kokën ka parë ushtrinë duke vrapuar dhe ka bërë titur ikni ushtria, prandaj është kthyer në shtëpi. Tutje ka dëshmuar se kur është kthyer në shtëpi e ka parë B. dhe i ka thënë “ikë”, i njëjti ja ka kthyer unë nuk iki dhe ka hyrë brenda duke i thënë dëshmitares ikë ti, e njëjta ja ka kthyer se unë nuk mundem me ikë pa ty, më pastaj kanë mbetur të dy në shtëpi, ku ka dëgjuar krisma e nuk ka parë asgjë deri në momentin kur kanë dal jashtë sepse shtëpia tyre ishte rrethuar me muri. Në një moment e njëjta ishte në ballkon, e ka thirrur B. me i ndërruar trenerkat me atë, pasi që i kanë ndërruar trenerkat ka dalë nga oborri dhe në momentin si e ka hapur derën ka parë ushtarë me pushkë – automat, ata i kishin thënë në gjuhen e tyre “bjer për toke” dhe në ato momente ka bërë titur duke e thirrur B. “.....” mos dil, ata ushtarët e kanë pyetur të njëjtën se kë e ke brenda dhe ajo i ka treguar, ata menjëherë kanë hyrë brenda në oborr, ata e kanë kapur vëllain e saj për dore dhe e kanë futur te shtëpia e të ndjerit H. që ka qenë komshiu i tyre me shtëpi ballë për ballë. Dëshmitarja në ato momente ishte shtrire te dera, më pastaj i kanë përzënë, dhe i kanë drejtuar tatëpjetë. Rrugës dëshmitarja e ka kthyer kokën mbrapa e ka parë B., S. dhe një person të tretë që nuk ka mundur me parë kush është si, ndërsa në afërsi të tyre ishin ushtarët. Pastaj i ka parë se i kanë futur në atë shtëpi, janë dëgjuar krisma ku e njëjta nuk ka mundur me i ndihmuar asgjë vëllait, rrugës kryesore duke shkuar e ka ndeshur nënën dhe babain me komshinjtë që kanë qenë aty.

Sh. K. e kishte parë duke dal prej shtëpisë së S. përjashta, ka qenë i përgjakur thotë dëshmitarja, ka qenë familja e M. – gruaja, motra dhe vajza, ka qenë M., L., familja Z., si dhe një familje tjetër që kishte shkuar me u strehuar. Ajo me prindërit dhe të gjithë që kanë mbijetuar në atë moment kishin shkuar te shkolla “.....” ku aty ishin disa serb dhe i kthyer nga kanë ardhur, aty janë ndarë ajo me prindërit e saj – nga komshinjtë. Dëshmitarja ka dëshmuar se duke mos pasur nga me shkuar ajo me prindërit janë kthyer nga shtëpia e tyre dhe me të mbërri në hyrje të mahalles aty ka qenë policia e stacionuar ku i kanë ndalur e i kanë pyetur se ku po shkoni, se babai i saj i është përgjigjur që po shkojnë me i marrë do ilaçe se janë të sëmurë dhe një polic

aty i kishte thënë se vetëm njëri mundet për të shkuar e këto dyja (pra dëshmitarja dhe nëna e saj) me qëndruar aty, e njëjta shton se babai saj nuk ka shkuar për arsye se nuk donin me u ndarë.

Dëshmitarja ka theksuar se pastaj ka vrapuar e para me mbërri te shtëpia e A. M., se kur ka dashtë me hy brenda kanë qenë duke rënë “lonët” e kulmit ngase shtëpia ishte duke u djegur, aty ka parë një person të shtrirë përmbysë me tesha ngjyrë kafeje, me të parë atë person nuk ka mundur me hyrë brenda se kishte pasur frikë dhe sipas dëshmitares aty kishte qenë edhe vëllai i saj por nuk e ka ditur. Se aty te oborri i shtëpisë së A. M. kishte qenë edhe vëllai i saj e ka kuptuar pas tre orëve kur ka dëgjuar se i kanë vrrarë, pra fjala për B., S., H. dhe një tjetër që nuk e ka ditur kush është. Momentin kur e ka kuptuar që është vrrarë vëllai i saj B. ka qenë kur ka dalë jashtë dhe i ka thënë një djalit të nacionalitetit serb, duke e lutur që të shkoj te shtëpia e A. për të shikuar se a është vëllai i saj aty, i njëjti njëherë nuk ka dashur pastaj nëna e tij kishte insistuar, i njëjti ka shkuar te shtëpia e A. dhe me tu kthyer i ka treguar dëshmitares se katër persona janë të vrrarë në oborrin e asaj shtëpi, në atë moment për dëshmitaren V. ishte e qartë se në mesin e tyre ishte e vëllai i saj B.

Tek shtëpia që ishin strehuar – te qytetaret e nacionalitetit boshnjaket kishin qëndruar deri me 1 prill ku nga aty i kishin larguar dy persona të quajtur Zh. dhe P. duke ju thënë me lëshuar shtëpinë se sherri që jeni shqiptar mund ti gjej edhe ata diçka. Në atë moment e kanë lëshuar shtëpinë duke shkuar te stacioni i autobusëve, aty kishte pas shumë ushtri sipas dëshmitares, kanë qëndruar aty dhe kanë pritur, ku më pas kishte arritur një kolon me shqiptar prej qendrës të cilëve u janë bashkangjitur duke shkuar me ta deri në Mal të Zi në këmbë.

Dëshmitarja gjithashtu ka dëshmuar se emrat e personave që i kanë thënë shtriju për tokë, dhe që ja kanë marrë vëllain nuk i ka ditur, por kujton se ka mbajtur mend shumë mirë fytyrat dhe në bazë të fytyrës e ka kuptuar se quhet Z. Dj., pra është ky personi që e ka kapur vëllain e saj për dore dhe e ka futur në shtëpi te H. Z. ka dëshmuar dëshmitarja. Më tej ka shtuar se policia në Pejë e kanë ftuar për të bërë identifikimin, të cilët i kanë treguar shumë fotografi, e njëjta thotë se e ka identifikuar personin dhe nuk e ka pas të vështirë për arsye se ajo fytyre që ja ka marrë vëllain i ka qëndruar para syve për njëzet vite. Personin që ja ka marrë vëllain, dhe që e ka identifikuar në Stacion Policor në Pejë e njëjta ka shtuar se e ka parë edhe në seance në sallë të gjykimit.

2.4. Dëshmitari – i dëmtuari Sh. K. në dëshminë e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: ai në vitin 1999 i ka pas 40 vjet, dhe me datë 28.03.1999 me gruan dhe fëmijët e tij kishte shkuar në shtëpinë e të ndjerit S. dhe H. Z., për arsye se një ditë përpara kishin dëgjuar se në lagjen “...” ishin bërë krime të mëdha, ishin bërë masakra dhe për shkaqe sigurie kishin shkuar sepse oborri i shtëpisë së tyre kishte qenë me i rrethuar me një muri të lartë dhe kishte hapësirë që të futnin veturat brenda. Kishin dëgjuar se në, janë vrrarë 48 shqiptar nga paramilitaret.

Me datën 29.03.1999 në mëngjes rreth orës 09:30-10:00 me H. Z. kishin dalë në oborr, kishte vërejtur se te shtëpia e dëshmitarit ishte një ushtar me uniformë dhe dëshmitari i kishte thënë H. ikë se po vjen ushtria, janë futur brenda dhe të gjithë kishin shkuar në bodrum. Pas 2-3 minutave ishte thyer dera e korridorit nga persona të armatosur duke bërtitur “dilni jashtë” herën e dytë duke thënë “dilni se ju kalli të gjithëve”, në ato momente kanë dalë në korridor së bashku me gratë dhe fëmijët, ku gratë dhe fëmijët janë urdhëruar që të dalin jashtë, ndërsa burrat kanë mbetur në korridor. Sipas dëshmisë së dëshmitarit fillimisht atë e kanë goditur me shuplakë, duke e pyetur cila është ushtria më e fortë, dëshmitari nuk ka ditur se si ti përgjigjej, prapë I ka thënë a është ushtria serbe më e fortë, dëshmitari I kishte thënë po, dhe pastaj një ushtar e kishte

goditur me kondak në kokë dhe ishte rrëzuar. Kur ushtari e kishte ngritur I kishte thënë; paret çka po pret, dëshmitari ja kishte dhënë 100 marka, sepse tjerat I kishte gruaja e tij, ndërsa ai ia kishte kthyer duke I thënë se janë pak për dy veta dhe duke e urdhëruar të dalë te gratë që të marrë para tjera. Dëshmitari kishte dalë jashtë ja kishte marrë gruas paratë dhe ja kishte dhënë. Dëshmitari ka shtuar se njëri nga personat e armatosur, I kishte thënë H. “*unë po të njoh diku*” ndërsa H. ja kishte kthyer “*po se vjen në qebaptore me Z. dhe pini piva derisa të msholet dugoja*”, në atë moment ai personi ka pas Kallashnikovin në dorë dhe I ka mëshuar H. me një plumb duke e goditur në pjesë të barkut ku nga ai plumb ai kishte mbetur I gjallë edhe pse ishte rrezuar ka deklaruar dëshmitari.

Më pastaj ky person dëshmitarit – të dëmtuarit Sh. K. ja ka hapur gojën i ka futur Kallashnikovin në gojë, dëshmitarin e ka kapluar gjaku por dhimbje nuk kishte ndjerë, sigurisht prej frikës deklaroi ai, dëshmitari kishte pas një unazë në dorë dhe ja kishte treguar, pastaj ja kishte kërkuar atë unazë duke I thënë shko te gruaja merre edhe arin, dëshmitari ka shkuar e ka marrë arin, ja ka lëshuar në dorë dhe në atë moment ai e kishte goditur me plumba edhe njëherë H., ky I fundit kishte qenë në bërryl pak I ngritur duke u mbajtur në njërin bërryl dhe nga kjo goditje më pastaj H. ishte shtrirë përfundimisht.

Dëshmitari më pas ka dëshmuar se pas pak ka hyrë S. është vërsulur të shkojë te vëllai, ndërsa ky personi i armatosur i kishte qitur Kallashnikovin në fyt duke I thënë “*paret*”, ai I kishte nxjerr paratë prej trenerkes ja ka qitur paratë në dore dhe arin, në të cilin moment I kishte thënë; “*se këto ju kanë shpëtuar kokën*” duke kërkuar nga të njëjtit të dalin jashtë. Në momentin kur kishin dalë jashtë kishin qenë 4-5 shokë të tyre – pra paramilitar, të veshur në uniforma, dikush me trenerka dhe në pjesën lartë uniformë, ku në mesin e tyre kishte qenë një person I quajtur Xh. të cilin dëshmitari e kishte njohur duke e kap dëshmitarin për fyti, dhe duke kërkuar nga personi brenda se çka me bërë me këta, ky I fundi I ishte përgjigjur “*lëshoj se kanë dhënë diçka*”. Aty kishte takuar B. të cilin kishin qenë duke e mbajtur. B. I kishin thënë nisu me këta të dy, do të thotë me dëshmitarin dhe S., sepse H. kishte mbetur në oborr i vrarë. Rrugës duke ecur në anën e majtë të rrugës kishin qenë afër 5-7 metra paramilitaret ku njëri prej tyre që ishte me uniform ishte afruar dhe I a pyetur për mbiemra, në atë moment ai paramilitari e kishte afruar gishtin te hunda e dëshmitarit, ndërsa S. dhe B. I kishte thënë të hynë në oborr, ku S. e kishin vrarë të parin dhe B. në dytin, sipas dëshmitarit S. e kishin gjuajtur në fytyrë dhe B. e kishin goditur në gjoks dhe ai ka rënë në traktor, pastaj ai paramilitari siç e përshkruan dëshmitari ishte kthyer kah ai duke I thënë; vrapo çka po pret, më pastaj dëshmitari kishte vrapuar pas 5-6 metrave e kishte dëgjuar edhe një krismë të pushkës dhe pas pak kishte qitur edhe dy herë.

Derisa po I detyronin të shkonin në drejtim të caktuar aty kishte qenë një person që dëshmitari kishte punuar me të, I quajtur D. A., nga aty kishin vazhduar edhe 30-40 metra ku ishte një kontejner I mbeturinave aty kishte qenë duke ardhur R. M. me një kurban në karrocë, në atë moment kishte vrapuar një ushtar duke I thënë ku po shkon duke filluar ta shaj dhe e ka gjuajtur me breshëri automatiku, dhe si pasojë e goditjes ishte rrotulluar dhe kishte mbet në tokë aty. Dëshmitari ka shtuar se më pastaj ka dal në rrugën kryesore ku kishte gjetur gruan me fëmijë, gruan e H. dhe S. me fëmijë dhe babain e këtij të fundit. Dëshmitari kishte kërkuar nga të njëjtit të laroheshin kishin vazhduar rrugës për te fabrika e bukës e quajtur “.....” ku aty kishte gjetur shumë banorë të lagjes që kishin ikur më herët, ndërsa ai me gruan, fëmijët dhe disa të lagjes disa kishin shkuar në tjetër drejtim.

Deri sa këta kishin vazhduar në drejtim të hekurudhës, rrugës kishte qenë një grua duke punuar punë dore, ndërsa më larg diku njëzet metra ishte një polic, ajo gruaja I kishte thënë; keni kërkuar NATO kthehuni, ai polici ishte me rroba të policisë duke ja bërë me dore që të ktheheshin, të

njëjtë ish in kthyer prapë ku kishin dalë të shtëpia e babait, aty kishin gjetur babain dhe nënën dhe ata të lagjes që i kishin përzënë një ditë përpara, aty kishin qëndruar një natë me krejt të mahalles ish in gratë e H. dhe S. si dhe V., thuhet gjysma e mahalles 50-60 veta ka deklaruar dëshmitari, dhe të nesërmen në mëngjes kishte shkuar një fqinjë i quajtur V. N. dhe ju kishte thënë, se dilni për Mal të Zi sepse nuk mundem me mbrojtë askënd më vjen keq por mos shkoni në Shqipëri se kush shkon atje nuk kthehet.

Më pas kishin vendosur të iknin, një person i quajtur J. I kishte thënë hajde ti marrim veturat dhe të ikim, I kishin marrë veturat dëshmitari kishte vozitur veturën e H. që kishte qenë caravan, veturën ..., ja kishte dhënë L. dhe veturën e tij ja kishte dhënë mysafirit që ishte te A. L. ngase ai kishte nënën në karrocë. Dëshmitari kishte marrë gruan e H., të S., gruan e tij me fëmijë, kanë shkuar në S. disa në këmbë, disa me vetura, një kolonë e madhe, nga aty kishin shkuar në R. ku kanë qëndruar 2-3 natë më pastaj kishin shkuar për në U. Dëshmitari më tej ka shtuar se asgjë deri atëherë nuk I kishin treguar familjes Z. dhe ditën e dytë sa ish in në U. I kishte mbledhur të gjithë dhe ju kishte treguar çka ka ndodhur. Me tutje dëshmitari ka deklaruar se 3-4 vite pasi ka ndodhur ngjarja ka dhënë deklaratë në KLMDNJ ku e ka përshkruar ngjarjen dhe se i kanë treguar disa fotografi për të bërë identifikimin, ndërsa kur dëshmitari I kishte thënë se ky po më përngjanë, T. D. e kishte kthyer fotografinë mbrapa, duke I treguar se ky është Z. Dj. nga fshati R. Komuna e P. dhe se aty kishte mësuar për emrin e tij. Se në ditën kritike tjetër kush e ka vrarë H. pra ai me vetulla të trasha dhe I gjatë, ndërsa për atë që e kishte identifikuar në KLMDNJ ishte personi që kishte vrarë S. dhe B., ndërsa kush e ka vrarë R. M. nuk e din ngase e kishte pasur mbrapa. Se personin me emrin Z. Dj. nuk e kishte njohur më herët. Dëshmitari ka shtuar se personi që I kishte ndalur me I pyetur për mbiemra kishte qenë personi që ka vrarë S. dhe B.

2.5. Dëshmitari – i dëmtuari M. Xh., në dëshminë e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: i kujtohet data 29.03.1999 ka qenë ditë e hënë, ishte në shtëpi ku dy fëmijët e tij donin me dalë në lagje për të bërë bajram, ndërsa dëshmitari kishte filluar për ti kërkuar ndërsa ata kishin ikur sepse kanë filluar krismat dhe nuk ka arrit për ti gjetur fëmijët. Rrugës duke u kthyer, para shtëpisë së V. një ushtar kryesor i ka thënë “lezhi” – bjer poshtë, dhe në atë moment ja kishte qitur këmbën dëshmitarit në qafë duke e shtrire për toke duke i kërkuar para.

Aty kishin qenë një grup ushtarësh, pasi i ka thënë ngrihu në këmbë, dëshmitari është ngritur dhe e kanë pyetur se a e ke dikën në shtëpi, ndërsa ai është përgjigjur se jo, ai ushtari që e ka përcjellë në shtëpi, dëshmitari ka dashur me ja dhënë paratë, i njëjti i ka thënë merri paratë se të duhen, këtë ia ka thënë në gjuhën shqipe. Ushtari kryesor që e ka quajtur dëshmitari kishte hyrë te shtëpia e H., edhe ai që i ka kërkuar paratë ka qenë ushtari kryesor sipas dëshmitarit, ndërsa ai që nuk ja ka marrë ka qenë ushtar tjetër ka shtuar dëshmitari. Atë ditë pasi i kanë përzënë i njëjti thekson se kanë qëndruar një natë te një shtëpi private dhe të nesërmen në mëngjes në ora 9 pa fëmijë janë nisur për në R., se djemtë nuk i ka takuar dhe nuk ka dëgjuar asgjë për ta, ndërkohë edhe djemtë e tij kanë menduar që ata i kanë vrarë. Se ditën kritike e ka parë V. para shtëpisë së saj te dera duke qajtur për vëllain e saj se nuk e dinte kush është vrarë në ato momente. Se dy ushtarët që i ka përmendur nuk i ka njohur më herët dhe nuk ja ka ditur emrat, por që me datë 26.02.2019 ka dhënë deklaratë në polici ku i kanë treguar edhe fotografi, duke përshkruar njërin person si personi që nuk ti ka marr paratë, dhe të njëjtin e ka mbajtur mirë në mend, sepse në atë kohë e kishte drejtpërdrejtë në ballë. Kujton se fëmijët e tij kanë shkuar në R. pas një javë neper bjeshkë, kishin qenë me këmbë të zbathura duke ecur tre ditë, këmbët i kishin pasur bardhë si bora, se ditën kur janë takuar me fëmijët ju ka ra të fikët të gjithëve sepse nuk kanë besuar që do i shihnin më, shton dëshmitari. Ai në R. ka qëndruar 18 ditë pastaj ka shkuar për në Shqipëri, ku me datë 30 Qershor 1999 është kthyer në shtëpi duke qëndruar në tenda sepse shtëpitë kishin qenë të djegur.

Dëshmitari ka shtuar se ka dhënë deklaratë në polici në Pejë në muajin shkurt, duke e identifikuar përmes fotografive ushtarin që nuk ja ka marr paratë përmes fytyrës dhe syve të gjelbër dhe se ka qenë biond është shprehur dëshmitari, nuk i kujtohej se ja ka parë flokët dhe se i njëjti në atë kohë i ka pas 20 deri 25 vjet. Në fund dëshmitari ka deklaruar se parashtrohet kërkesë pasurore juridike.

2.6. Dëshmitarja B. M., në dëshminë e saj dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: i kujtohet muaji Mars 1999 ku të gjithë kishin dalë përpara banesave, se deri me datë 29.03.1999 kanë qenë në banesën e tyre me familjen, adresa ka qenë “...”, objekti është njohur si “...” në P., se në atë banesë kanë jetuar prej vitit 1978, në katin e 9. Fqinjët i kanë njohur, kanë pasur një përshëndetje se hyrje – dalje nuk kanë pasur por din se kush ka banuar aty, se në atë hyrje kanë banuar nacionalitete të ndryshme si shqiptar e serb, ai objekt ka qenë 13 katesh dhe mbi katin e dëshmitares kishte banuar tani i pandehuri Z. Ai kishte banuar aty me familjen, nënën dhe babain, si dhe dy motra të tij. I kujtohet se me datë 29.03.1999 kur kanë dalë nga shtëpia me fqinjët shqiptar, fqinjët serb nuk i ka parë. Dëshmitarja thekson se kanë hipur në veturë dhe kanë vazhduar në Mal të Zi dhe deri në Tetor të vitit 1999 nuk janë kthyer. Momentin që janë kthyer thekson se banesën e kanë gjetur pak të tollovitur, se aty kishin gjetur fqinjët ngase të njëjtit ishin kthyer pak më vonë në banesë, ndërsa fqinjët serb nuk i kanë takuar kur janë kthyer sepse nuk kanë jetuar më aty. Para datës 29 Mars është takuar me Z. Dj. duke theksuar se janë përshëndetur vetëm me përshëndetjen mirëdita – mirëdita sepse dëshmitarja kishte punuar prej 7 deri 3, se Z. e ka takuar 3-4 ditë para datës së largimit dhe se takimi ka ndodhur në hyrje të ndërtesës. Dëshmitarja ka shtuar se të pandehurin apo ndonjë anëtar të familjes së tij nuk e ka takuar ndonjëherë para shqyrtimit gjyqësor, të njëjtin e mban mend prej fëmijë kur kanë qenë dhe si i rritur. Se nëna e të pandehurit ka qenë motër medicinale në spital. E njeh I. K. si ortoped shumë të njohur në Pejë por nuk ka pas ndonjë trajtim tek ai. Dëshmitarja ka shtuar se me Z. kanë pas raporte fqinjësore dhe se atë nuk e ka parë në uniformë, e as me armë në dorë. Sa i përket të pandehurit e njëjta ka theksuar se ka qenë djalë i mirë, prindërit e mirë. Dëshmitares në shqyrtim gjyqësor i janë prezantuar fotografite që janë përdorur në procedure paraprake për të identifikuar personin, por me numra të mbuluar ajo ka vendosur gishtin në fotografinë numër 3, ku në bazë të procesverbalit të identifikimit të personi nën tre gjendet i dyshuari Z. Dj.

2.7. Perfaqësuesi i palës së dëmtuar të ndjerit R. M. – F. M. në dëshminë e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: është djali i të ndjerit R. M., në vitin 1999 I ka pas njëzetë e pesë vite, se ka qenë madhor dhe I kujtohej ajo kohë. Se me datë 24.03. 1999 kur kanë filluar bombardimet e NATO, ata I kishte ndjekur ushtria prej asaj lagje duke kaluar një lagje tjetër duke qëndruar te një komshi I quajtur M. M. ku kishin qëndruar atë natë dhe ditën e nesërmen kishin shkuar në lagjen ku ka ndodhur rasti duke theksuar se aty kanë pas një kushëri me emrin A. M. me krejt familjen, që do të thotë se ka qenë edhe I ndjeri babai I tij R. M. Me datë 29 Mars kur I kishin larguar nga lagja e dytë babai I tij pra R. M. kishte dalë afërsisht rreth një orë para se me I ndjekur nga ajo lagje, dhe që nga ajo kohë dëshmitari më nuk kishte ditur për babain e vet deri në vitin 2005 kur e kanë kthyer prej varrezës masivë në B. të S. Dëshmitari më tej ka dëshmuar se vitin e kaluar dëshmitari Sh. K. ka shkuar te lokali ku ai punon dhe I ka thënë se e ka parë krejt rastin qysh ka ndodhur, duke I thënë se babai I vet ka qenë duke u kthyer me një kolicë, se e ka dëgjuar dhe e ka parë kur kanë gjuajtur në të. Dëshmitari gjithashtu ka theksuar se informatat për vrasjen e babait të tij I ka marr prej njerëzve, se kush ka marë pjesë në ato krime ai personalisht nuk e ka ditur, por I kanë treguar që Sh. e ka parë krimin kur është vrarë R. M. dhe kur kishin biseduar Sh. I kishte thënë se ka qenë Z. Dj. ai që ka vrarë babain e dëshmitarit.

2.8. Dëshmitari F.r Sh. në dëshminë e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: deri me datë 20.03.1999 ka punuar si team lider në sigurim në OSBE në Pejë, deri me datë 20.03.1999 është data kur ai mision është tërhequr. Detyra e tij e punës ka qenë sigurimi I objektit dhe sigurimi I personelit të OSBE, kanë pas disa pika të drejtimit brenda ndërtesës, kontrollin e hyrjeve – daljeve dhe krejt kontrollin e ndërtesës. Ka qenë rregull nëse ka munguar dikush nga stafi vendor automatikisht me treguar që me u bërë zëvendësimi I tij, se pikat nuk kanë mundur me mbet pa mbulesë, gjë që ka ndodhur para fillimit të ndërrimit, duke theksuar se 15 minuta para fillimit të ndërrimit e kanë verifikuar listën dhe janë caktuar personat ku kanë pas me qëndruar. Shumica e punëtoreve kanë qenë të nacionalitetit shqiptar, gjatë asaj kohe janë punësuar dy persona të nacionalitetit serb në transport, një ka qenë në sigurim në ekipin e dëshmitarit, ai që ka qenë në ekipin e tij ka qenë Z. Dj. që ka punuar si oficer sigurimi dhe se nuk I kujtohej data kur ka filluar për të punuar I njëjti, por din se ka qenë gjysma janarit dhe se natën kur është tërhequr misioni nuk ka qenë, se në ndërrimin e fundit nuk ka qenë Z., kishin punuar 2 shqiptar ngase ndërmjet dy ndërrimeve kishe qenë pushim prej 48 orë.

Kohën kur Z. është punësuar në atë mision ka pasur dyshime se ishe me ndonjë mision prej policisë. Dëshmitari ka shtuar se gjatë asaj kohe pasi kanë fillua sulme e NATO-së ka qëndruar në shtëpinë e tij dhe se ditën e fundit të bajrami, ka dëgjuar se në lagjen “...” ka pas të vrarë, me një lagje kanë vrarë tetë meshkuj, ku afër tyre kishin filluar me I djeg lokalet. Ajo luftë kishte qenë kundër popullatës civile ku si qëllim ishte zbrazja e qytetit të cilit qëllim edhe ja kishin arritur ku vet dëshmitari ka shkuar në R. në ditën e fundit të bajramit, arsyeja e largimit nga shtëpia kishte qenë se në atë moment kishe shkuar një djalë serb 30 vjeç duke i mbledhur 2-3 veta të lagjes, e duke I thënë ikni se po vijnë paramilitarët se po bëjnë vrasje dhe po plaçkitin. Dëshmitari ka theksuar në shqyrtim se e njeh Z. edhe tani dhe e ka identifikuar në fotografi në polici dhe në sallë të gjykimit ka bërë me dorë nga I pandehuri duke thënë që është ai por që ndryshimi është I dukshëm.

2.9. Dëshmitari S. T. në dëshminë e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: Z. Dj. e njeh ngase ka qenë supervisor i tij derisa kishte qenë OSBE në P., ku përqindja e punëtorëve ishte 98% shqiptar dhe 2% të nacionaliteteve të ndryshme dhe më tepër serb ishin në transport. Kushti i vetëm që Z. të punësohej si sigurim ishte të hiqte vothin nga veshi dhe me të kuptuar dëshmitari që Z. kishte qenë polic kishte shkuar te K. një punëtor staf internacional i asaj kohe që punonte ne OSCE, duke i thënë se ju po kërkoni sigurim e po e shtini policinë në gradë, duke ja kthyer i njëjti se; *e dimë që është polic me qëllim e kemi marrë sepse nëse dogmë me lëshu ndonjë fore e lëshojmë përmes tij dhe se keni kujdes në cilin ndërrim po e lejon.* Dëshmitari kishte zgjedhur F. Sh. si shef të tij për shkak se ai kishte eksperiencë më tepër dhe ishte në duar të sigurta, duke shtuar se me të pandehurin nuk kanë pasur probleme as me sjellje të tij e as me vonesa, kjo periudhe kishte qenë mesi i misionit, shkurti apo fillimi i Marsit por që Z. kishte punuar deri në fund të misionit të OSBE, ku fundi i misionit të OSBE ishte 20 ose 22 mars. Dëshmitari ka theksuar se Z.n e ka takuar një ditë para bajramit në vitin 1999 në mars, sepse atë ditë dëshmitari kishte pas vajzën të sëmurë ishte nisur për ta dërguar te mjeku, pastaj me të përfunduar te mjeku kishte hyrë me pirë një kafe, pas përfundimit të kafes ishte takuar me Z. ballë për ballë duke cekur se ai kishte qenë shumë keq në fytyre dukej i lodhur, dhe i ka thënë “o Z.” i cili kishte qenë veshur në rroba civile, dëshmitari i kishte thënë shko kah K., gjë që të pandehurit nuk i kishte ardhur mirë dhe kishte filluar me sharjet, pasi kishte bërë 2-3 hapa i pandehuri ishte kthyer me fjalët “të lutem merre familjen dhe ikë” duke ja kthyer shpinën dhe ka ikur, kjo mënyrë e paralajmërimit dëshmitarin e kishte shtyre të mendonte dhe dëshmitari kishte ikur në R. me familje, gjatë rrugës kishin pasur peripeci të ndryshme. Dëshmitari kishte banuar afër parkut të madh të qytetit të P. që është quajtur mbi kanal. Citat “*po ju tregoj që natën e parë dhe të dytë e kemi kaluar te kojshit e parë që ka qenë boshnjak, po thuajse të gjithë kojshit që*

ishin afër shtëpisë time jemi mbledhur te ata në podrum poshtë, dhe bombardimet që kanë filluar, një polic e kemi pas në mahalle e ka pas shtëpinë afër parkut dhe kalonte afër kanalit dhe gjuante me kallashë me siguri me na shti frike dhe dy netët e para i kemi kaluar te kojshia, unë insistova me u larguar dhe e disha që isha në liste, shoqja pranonte me ikë prej shtëpisë tha se shumë po frikohesh. Natën e tretë i kam thënë gruas po shkojmë te babai i vet dhe shkojmë ti shohim, i kam thënë se nuk do të shkojmë më lartë, ata kishin kojshit krejt serb dhe kishin premtimet se do ti ruajnë. Relacioni ajror prej shtëpisë time është gjysme kilometri, ndërsa bombardimet e para janë bërë në lagjen time, e vetmja shtëpia ime ka shpëtuar sepse policia e ka pasur si bazë, se prej aty u shihte ..., dhe pjesa te stacioni i P. Dëshmitari ka deklaruar se ishte në listën për tu pushkatuar, këtë e kishte kuptuar pas luftës, kishin gjetur listën e personave që kishin me u pushkatuar, ne atë liste kishte qene dhe vet dëshmitari, ku të njëjtin e kishin kërcënuar disa here jo direkt sepse kishte një post në OSCE.

Ditën kur e ka takuar Z. ishte situata e tensionuar, dhe se ajo ditë që është takuar me Z. ka qenë fat, pasi fjalët që ja ka thënë i pandehuri, e shtynë të shkojë të marrë benzinë për veture dhe të largohet duke konsideruar se është lloj falënderimi ndaj të pandehurit sepse dihej situata çfarë ishte në atë kohë. Citat *“për këtë rast konkret nuk kam asgjë, ikja prej P. në dite bajrami, përmes S. kaloja andej krejt ata që i njihnim disa boshnjak që punonin në SUP, dikush shkante për R. një kolon vinte prej Malit të Zi dhe u vidhte materiali neper dyqane, sepse ishte para bajramit dhe gjitha dyqanet ishin të furnizuara, dhe ajo rruge ka qenë shume mundimshme prej mëngjesi kur kemi dal deri ora 13.00 kur e kemi kaluar, vinin informata që po kërkohen nga çdo person para here 1000 marka, here nga 500 marka, dhe gruaja i ndajke parat, dhe thonin se po i merrnin vajzat e bukura, unë shogën e kam pas të bukur dhe kisha atë frikë, ka pasur situata kur i merrnin kerret, e di se ka pas njerëz që kane pasur edhe para në kerre, ka qenë një tmerr i hatashëm derisa kemi dal në R. Intervistat e mija që i kam dhënë në U., mundeni me i gjetur dhe për televizione dhe nuk ka asgjë fshehje, këto mundeni me i gjetur në internet.*

2.10. Dëshmitari – i dëmtuari L. H. në dëshminë e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: data 29.03.1999 ishte ditë e hënë, ka qenë i punësuar në fabrikën e auto pjesëve “...” në P., deri me datë 26 ka punuar. Me datë 29 i ka takuar dy persona të lagjes që kanë qenë edhe ata punëtor duke u kthyer nga fabrika, të cilët i kanë thënë mos shko se nuk ishte mundësia që atë ditë të punohej, por nga kurioziteti dëshmitari kishte shkuar dhe kishte hipur te binarët e trenit lartë, duke vrojtuar në pllato te porta e fabrikës, ku kishte vërejtur se atje kishte persona të armatosur, shumica e tyre kishin qenë të maskuar me tre vija në ballë dhe fytyrë. Me tu kthyer mbrapa për në shtëpinë e tij, dëshmitari kishte takuar tre persona si V. H. i vrari i parë, M. G. i vrari i dytë dhe Z. D. i mbijetuar dhe me të mbërritur te lagja para se të hyjë te shtëpia e vet kishte dëgjuar krisma. Citat *“atje kanë lëshuar zë se është vrarë V. H., ai është vrarë te shtëpia e vet, për M. e Z. ku i kane qu nuk e di nuk kam dëgjuar. Kur kam shkuar në shtëpinë time e kam gjetur vëllain i cili është gjallë sot, ka qenë me kerr Jugo 45 A ngjyre portokalli, kanë qenë shoqja jem dhe vëllau, kunata me qikë ka qenë ende te shtëpia, janë dëgjuar krisma i kam thënë vëllaut qu dil më shpejt, në atë moment bashkëshortja e vëllaut ka kërkuar ndihmë nga shoqja ime me marrë sene dhe u kthye, djali im i vogli tre vjet e gjysme ka mbetur në kerr, vëllaut ja kam hapur dyert e oborrit dhe ka dal së bashku me fëmijët e mijë, kur ka dal djali nuk ka nejt se i vogël, është kthyer se vëllau i tij ka qenë në ulësen e mbrapme kane qene tre femijë dhe ky është bërë i katërti, vëllau ka dal në rrugën kryesore që është rruga e vjetër e “...”. Kur ka dal vëllau aty e kane sinjalizuar polici që ka qenë më poshtë “stani stani” – ndalu ndalu, ai nuk është ndalur ka vazhduar, e ka gjuajtur me katër plumba kerrin, sa plumba i ka shkrep se di, por kane qenë shenjat e katër plumbave, prej atyre katër plumbave janë plagosur dy djemtë e mi, djali i madh qysh e ka kap djalin e vogël ka qenë i depërtuar në dorën e djathtë me plumba, djali i vogël ka qenë mbrapa në shpinë dhe shumë pak ka depërtuar. Djali i madh ka qenë nëntë vjeç, i vogli*

tre vjet e gjysmë. Kur kanë filluar krismat ju kam thënë shoqes dhe kunatës që sa ma shpejte me dal, kam shkuar tek dyert ka gjuajtur dikush nuk e di kush, e kam dëgjuar plumbin duke fishkelluar rrugës dhe jam kthyer mbrapa i kam lënë dyert ashtu kam dal bashkë me shogen, kunatën dhe qiken e vëllaut, kam dal nga ana e prapme e shtëpisë. Si kemi dal andej kanë ardhur tre paramilitar apo çka kanë qenë nuk e di pas meje, njëri prej tyre ka qenë vetëm i lyer se ka pas maskën, na kane qitur neve tre meshkujve dhe na kane lyp paret me na plaçkitur, i kam qitur paret që i kam pasur dinarë, më ka thënë “marke marke”, njëri ka fol sikur me qenë Rus sepse nuk e njihje mire gjuhën dhe unë i kam thënë “nuk kam marka dhe unë punoj aty” (i kam thënë në gjuhën e tyre) i thash si e kam marrë rrogën që ku e kam, se rrogën e kam marrë të premtën, na kane qitur dhe na kanë bashkuar me të tjerët që kanë qenë gratë e fëmijët, njeri prej tyre mu ka afruar dhe ma ka qitur automatën në gjoks, qika e vëllaut ka filluar me u trishtuar, kuku e vranë axhën i ka ra si të fiket. Një tjetër ka qenë punëtor i fabrikës tonë e kam njohur dhe më ka njohur sigurisht, ka qenë distance 50 metra ndoshta, ka qenë në shkallë të shtëpisë tjetër përballë atje kur e ka dëgjuar këtë tu bërtit ai u shpreh; “lëshoni njerëzit ...” në atë ka ardhur njëri që e kanë pru më vonë me punuar, ka qenë inxhinier njëfarë D., kish marrë pjese edhe në luftën në Kroaci, dhe kur ka ardhur te telat, afër 30 metra diku, ai ka bërtitur dhe i ka urdhëruar ata që vendosni maskat, e ka vendosur maskën edhe ai që se ka pas, maska trekëndëshe te gjelberta, diku 25 cm, është dukur vetëm pjesa e syve që mos me mujt me i njohur. Ne kemi filluar me dal, na kanë thënë hajde ma shpejt ma shpejt, kur jemi dal në ballë në rrugë i kemi parë familjaret e viktimave duke ardhur, meshkujt kane qenë një distance mes tyre, atyre familjareve ju kane thënë ecni dhe neve, kemi vazhduar rrugën me dal në rrugën dytësore andej. Dëshmitari më tej ka shtuar se duke vazhduar më andej afër trafos e kanë vranë edhe R. qe kishte qenë varmihës. Me të dal në rrugën kryesore na ka zënë Sh. K. me familjen e vet, ai ka qenë i ndamë dhe ata dy i kanë ekzekutuar ka deklaruar dëshmitari. Lagja në të cilën ka banuar dëshmitari është quajtur te rruga “.....” që tani quhet rr.“.....”, se atë ditë burrat që i kishin futur te shtëpia e A. M. ishin S. Z., Sh. K. dhe B. B. Se tre paramilitarët që i kanë pas për ballë dhe tre që i kanë plaçkitur, nuk ka mundur me i identifikuar sepse ishin me maska, ku ka theksuar se vetëm njërin që ka qenë punëtor i fabrikës ka mundur ta identifikoj sepse nuk ka qenë i maskuar.

2.11. Dëshmitari – i dëmtuari F. H. në dëshminë e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: prej 1985 jeton në lagjen “....” dhe e njeh shume mirë atë lagje, rruga te shtëpia e tij sot quhet “....”, në atë lagje ka jetuar familja Z. B. edhe disa të tjerë. Sa i përket datës 29.03.1999 kujton se ka qenë java e parë e bombardimeve të NATO-së, ai ka qenë njëzetedy vjeçar, se ishte dita e dytë e kurban bajramit dhe se atë ditë ishte një aksion i madh i ushtrisë serbe në lagjen e tij. Aksioni fillimisht kishte filluar me dëshmitarin dhe B. H. djali i dajës së tij, ka qenë ora 09:10 në mëngjese ku dëshmitari kishte shkuar te daja i cili e kishte shtëpinë njëzet metra larg për ta pyetur çfarë do të bëjnë, në atë moment kishte arritur daja i tij L. i cili kishte qenë në lagjen tjetër, duke i thënë dajës B. merre veturën dhe ikë se po ikim krejt. Dëshmitari në ato momente ishte kthyer në shtëpinë e tij duke e njoftuar babain e vet dhe pastaj kishte dalë në lagje para derës se shtëpisë së A. M. Aty ishte afruar me veturën Jugo 45 ngjyre e kuqe të portokalltë daja i tij, duke i thënë se po ikim se kishin hyrë një lagje tjetër, në ato momente kishte dalë një ushtar me tessa të ushtrisë lara lara te dera e S. apo V. apo e B. B. siç deklaroi dëshmitari dhe për një moment në gjuhën e tij i kishte sharë duke shtënë me automatik me e vranë dëshmitarin dhe dajën e tij, me breshëri 4-5 plumba kishte shkrepur nga një distancë 65 metra larg maksimumi, më pastaj daja kishte hipur në veturë për të ikur, ai ushtari kishte vazhduar të gjuante në drejtim të veturës, në ato momente dëshmitari duke ikur për të hyrë në shtëpi kishte kthyer kokën mbrapa ku kishte parë atë ushtarin duke hyrë në shtëpinë e Z. Dëshmitari ka shtuar se në ato momente ka hyrë brenda dhe ju ka treguar familjareve çka po ndodhe dhe të gjithë kanë filluar të ecnin deri në fund të bahçes te muri i fqit H. B., duke hyrë në bodrum. Babai i dëshmitarit F. kishte kërkuar që ai dhe djali i axhës së tij të hipnin në kulm të shtëpisë se ndoshta

do të shpëtonte dikush, kulm i cili ishte i përkohshëm dhe mund të shihej përmes dërrasave. Pas 1-2 minuta e ka parë të njëjtin polic duke vazhduar përpjetë e duke u ndalur te udhëkryqi te vetura e dajës së tij B. dhe aty kishte gjuajtur 2-3 here në drejtim të shtëpisë së dajës, më vonë kishte kuptuar që e ka gjuajtur dajën Lute. Polici i njëjtë është kthyer poshtë ka dëshmuar dëshmitari, menjëherë tek vendi ku më parë e kishte gjuajtur dëshmitarin duke u kthyer pastaj te shtëpia e I. dhe S. duke qëndruar aty tetë deri dhjetë minuta, më pastaj i njëjti polic me një tjetër dhe disa të tjerë prapa tij kishin arritur te oborri i shtëpisë së dëshmitarit ky aty kishin hyrë tre polic, ai i cili i kishte gjuajtur më herët me i vrarë, një më i shkurtër i plotë, dhe një më i ligësht më i gjatë pak më i vjetër se tridhjetedy vjeç me flokë të rrume është shprehur dëshmitari. Dëshmitari ka shtuar se të gjithë policët kishin pas vija të zeza në fytyre në ballë dhe me të hyrë në oborr njërit nga policët i kishte bërë “tokivoki” – radiolidhja, aty kishte kuptuar dëshmitari se ai është lidhur me snajperistin lartë, ku ai i kishte thënë “atë të gjatin (pra për dajën e dëshmitarit) e kam gjuajtur nga lartë, se ashtu kështu ai rrugës diku duhet të jetë, se ai tjetri ai ekstremisti nuk ka dal shikojeni se është diku brenda (kishte pas fjalën për babain e dëshmitarit)”, se tërë këtë bisedë dëshmitari e kishte dëgjuar që e kishin bërë policët në radiolidhje sepse policin e kishte në afërsi katër metra larg nga kulmi, sepse shtëpia e tij ishte njëkatëshe. Me tej dëshmitari ka deklaruar se ai që kishte pas shaminë e kaltër me lule të bardha ishte ngjitur shkalleve tek shtëpia tjetër për të shikuar mos është dikush, se fytyrën e tij nuk e harron, duke theksuar se bie me fjetur dhe zgjohet me atë fytyrë përpara, dhe e përshkruan; ai kishte qenë një djalë afërsisht 4-5 vjet më i moçëm se dëshmitari, me flokë të zeza të ndara në mes, me zylyf, me sy jeshil (gjelbër).

Dëshmitari ka deklaruar se në moment veturën që e kishin pasur në garazh dikush e kishte ndezë prej policeve sepse çelësat i kishin pas në veturë, duke e nxjerrë jashtë, një polic kishte hyrë te dera e grazhdit dhe atij që i ka gjuajtur me automatik i ka thënë: “Z. ima neshto tamo” (Z. a ka diçka aty), ku tjetri i kishte thënë po brenda janë i kemi zënë e nuk po dina çka me ju bërë, a ti presim në fyt apo ti nxjerrim sytë, apo ti masakrojmë. Citat “në këtë moment dikush e ka dhez veturën dhe e ka qit jashtë, ai që ka qenë me shami shajti me nanë se kush e mori veturën, ai që ka hy te dera e garzhës ka qenë një ushtar me tessa të njëjta, më i gjatë se ky, me sy të zi nëse nuk gaboj, me vetulla të trasha me automatik në dore me kondak të drunit, me thihe te madhe të futur në gjoks, mua më ka bërë me kuptuar se ai ka qenë shefi aty, se kur piskatke ai këta u dridhnin. Pasi ka shkuar ky poshtë polici herën e pare kur ka ardhur deri te rruga e dajve, pra ai që na gjuajti, dhe kam dëgjuar atje të shtëna nëse nuk gaboj kane qenë dy të shtëna, më vonë polici tjetër më i shkurtër që ishte se bashku me atë në oborr që na gjuajti e ka hequr nga brezi një sikur bombe, i ka hequr njëfarë fitili, me shkrepës e ka ndezë afër drunjëve që ishin 6-7 metra dru, dhe brenda një minute u dhezën drutë – ata morën flake edhe kane dal nga oborri të tre dhe u bë shumë zjarrë aty dhe nuk mundeshin me hyrë më, pas 2-3 minutave që kanë dalë jashtë të gjithë, janë dëgjuar dy refalle në shtëpinë e A. në oborrin e tij. Aty para refallave gjatë kohës që kanë qenë këta në oborr te unë është dëgjuar një zhurme e veturës që është nxjerrur nga shtëpia e A., unë kam menduar që ka qenë traktori dhe vetura ngjyre jeshil, por ka qenë edhe një veture e M. ka qenë veture e bardhë nëse nuk gaboj Golf 2, pasi kemi ardhur pas lufte veturën e A. dhe traktorin i kemi gjetur të djegura ndërsa veturën e bardhe nuk e kemi gjetur. Do të thotë gjuajtja me armë në shtëpinë e A. ka ndodhur pasi kane dal ata nga shtëpia ime, aty e kam kuptuar se dikush është vrarë, se pari kanë sharë, unë i kam dëgjuar, ju kanë thënë kthehuni, dhe janë dëgjuar dy refalle me 4-5 plumba, unë nuk kam parë kush i ka vrare apo ka shti në ta, por pasi që kanë dal nga oborri im dhe kanë ardhur ata nga poshtë ka ndodhur vrasja. Aty janë vrare dy persona njeri ka qenë jakne bojëkafe dhe ai ka ra me fytyre në gomën e traktorit, dhe tjetri ka ra si përmbys nuk kam ditë kush është vrare por e kam dite që dikush është vrare, pastaj pas 1-2 minuta janë dëgjuar 2-3 të shtëna diku 70-80 metra më larg tek trafoja edhe aty e kam kuptuar që dikush është vrarë. Pas 4-5 minutave ka filluar grumbullimi i ushtareve para shtëpisë time respektivisht para shtëpisë së A. M. dhe aty ka ardhur një veture e bardhe prej nalt me të cilën

kanë qenë dy ushtar brenda në veturë, vetura ka qenë e preme e adaptuar për vendosjen për pushkomitrolezit të madh, aty kane qene dy brenda, njëri pinte duhan, dhe i treti ka qenë hipur dhe e mbante pushkomitrolezin ishte në këmbë ishte me një shami si të portokalltë dhe ka qenë me vija në fytyrë. Ata janë bërë bashkë para dyerve të shtëpisë, unë kam menduar se janë dymbëdhjetë deri pesëmbëdhjetë ushtarë sigurisht kane qenë më shume se një pjese afër murit si kam parë, dhe aty janë bërë tub duke folur në gjuhen e tyre “hajde ushtria serbe marsho” këtë e ka thënë ai që jepte urdhra, ai personi me vetulla të trasha i gjatë, dhe ai i ka thënë atij që na ka gjuajtur më herët neve “. këqyr a ka diçka brenda” ky i tha “jo pastër është krejt”

Pasi kanë shkuar policia e kam pare J. dhëndrin e A. i cili ka ardhur nga mahalla tjetër ka hy ne oborrin e A. dhe ka dal menjëherë. Pas një gjysme ore ose katër dhjetë minuta ka ardhur i njëjti se bashku me bashkëshorten motrën e A. kane hy në oborr një ose dy minuta dhe kanë dalur nga oborri. Më vonë kam dëgjuar prej tyre që J. kur i ka pare dy të vrare në oborr ka shkuar i ka thënë bashkëshortes së vet pra motrës së A., duke i thënë se vellaut tënd ja kishin vrare djemtë në oborr, dhe kur kane ardhur se bashku N. i ka thënë burrit se nuk janë djemtë e A., se njërin me vështirësi e njoh se plumbat i kane ra në koke dhe i është prishur fytyra. Pas një ose një ore e gjysme e kam parë S. – babain e B. B. ka qenë vet i dyti, apo i treti ata ka ardhur te poshtë deri në fund të mahalles dhe është kthyer përpjete dhe e kam parë që ka qenë me bashkëshorten M. dhe vajzën V., ndërkohë trupat e vrarë kanë qenë ende pa i marr askush. Diku rreth orës 13:00 ka ardhur një kamion i formatit T. Z., dhe para kamionit ka ardhur një veturë e bardhë me dy polic brenda dhe është ndalur te dyert e A. pas saj është ardhur kamioni aty ka qenë një ushtar me tesha të ushtrisë dhe dy civil, për mendimin tim kane qenë të komunitetit Rom me tesha civile, janë ndalur te dyert e A. dhe njeri nga policet ka dalë nga vetura dhe i ka thënë shko poshtë, aty e kam kuptuar se kane ardhur me i marrë trupat e vdekur. Kamioni poshtë ka qëndruar dy deri tre minuta, është kthyer e ndal te garazha ime dhe unë e shihja një pjesë të kamionit dhe aty e pashë që ka pas edhe trupa të tjerë të vdekur, aty kane hyrë edhe ata dy, e kane marrë njërin nga trupat e kane hedhë në kamion dhe e kane marrë edhe trupin tjetër duke e hedhur në kamion. Më vonë e kam kuptuar që është vrarë R. M. i cili ka qenë duke shkuar te A. me kolicë në dore me kurban, aty është gjetur këpuca dhe leja e njoftimit të tij, ai është vrare dy deri tre minuta pas vrasjes në shtëpinë e A. E kam parë Sh K duke ecë përpjetë, si duke ngarë dhe e fshinte gojën i dilte gjak.

Në vitin e kaluar e kam parë ne portale që dikush po akuzohet për vrasjet në “.....” dhe aty e pashë emrin e M. Z. qikës axhës babait, dhe menjëherë e kuptova që fjala është për krimet që janë bërë në mahallen tonë, aty lexova emrin Z. Dj. për here të pare si i akuzuar dhe menjëherë kam hyre në facebook e kam shënuar emrin, pashë shumë Z. dhe menjëherë e identifikova njërin se jam 100% i sigurte se ai ka qenë Z. që na ka gjuajtur mua dhe dajën me na vrarë. Pas kësaj e kam thirrur E. ai është fëmija e H., dhe i kam thënë dëgjova se kishte filluar një gjykim e dëgjova emrin Z. dhe i thash eja të tregoj kush na ka gjuajtur dhe e identifikova përmes disa fotografive të me hershme që i kishte ne facebook, ishte ngjyra e syve dhe flokët e tij ajo që më beri ta identifikoj më shumë.

2.12. Dëshmitari – i dëmtuari A. N. në dëshminë e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: në vitet 90 - ta ka banuar afër stacionit të autobusëve, Bashkësia Lokale “....”, aty ka jetuar nga vitet 1968. Nga viti 1990 është marrë me aktivitete paralele, ka qenë aktivist dhe e ka mbuluar territorin ku ka jetuar. Prej datës 24 mars deri 28 1999 ishin me familje, dhe me datën 28 mars ishin larguar me dhunë në një mëngjes të hershem nga një grup i armatosur, ku sipas dëshmitarit pjesë e të cilit ka qenë edhe i pandehuri. Ky i fundit kishte arritur edhe ka kërkuar me emër një person i cili kishte punuar si llamarinë punues, por fati i tij sipas dëshmitarit ai ishte larguar së bashku me familje më herët dhe këtë e kishte bërë nga frika.

Më pas ka vazhduar me dëshminë e tij citat “*Këta e kanë lypë se ai i ka pas do automjete, ato ditë P. ka qenë katrahurë, aty s’ka pas kontroll ka qenë rrezik për jetë, kanë ardhur me dhjetëra njerëz, ske ditë kush vjen aty, ushtri apo paramilitarë, njerëz vrasës. Të pandehurin unë e kom parë, sepse lagjja ime është si trekëndësh, jetojnë 33 shtëpi, ka shqiptarë, shumica shqiptare na thojnë M., sepse P. ka pas ma shumë malazez, dikun 5-6 shtëpi janë,. Kanë ardhur e kanë lyp L., kanë bërtit, janë thyer dyert e shtëpisë dhe e kanë marrë një kerr, dhe janë larguar. Pas orës 12:00 ka ardhur vet së bashku me tre persona të tjerë, Z. Gj. ka ardhur, personi i quajtur S., mbiemri nuk më kujtohet, ka ardhur një taksist dhe një person i katërt. Kanë ardhur me kallashnikovë, me setra – jakne kamuflazhe ushtarake, kanë kërcënua në ajër me kallash, na kanë dhënë afat 5 minuta dhe kanë than në gjuhën serbe “dilni të gjithë jashtë, pesë minuta keni afat”. Lagjja jonë përbëhet nga tri hyrje dalje, dy për automjete dhe me këmbë. Kush ka mujt mu largu janë largu. E kom pas vajzën e vogël dhe na kanë nda te furra dhe te rrethi i OSCE-së, dikush për Shqipëri, ne kemi shkuar për Mal të zi”.*

Dëshmitari ka shtuar se të pandehurin herën e pare e ka pas larg afër njëzet metra kur kishte shkuar te shtëpia e L., herën e dytë ishte afruar në mes të lagjes duke gjuajtur me armë kallash, më pastaj i pandehuri S. duke kërkuar të largoheshim e duke share me fjalët banale, si “Shiptari, krejtve duhet me ju vra, shkoni për Shqipëri”. Dëshmitari ka vazhduar dëshminë e tij duke theksuar se të pandehurin e njeh afërsisht prej viteve 90 –ta, të njëjtin e kanë thirrur Z. dhe se kishin vijuar shkollën e njëjtë, se dëshmitari ishte aktivist i LDK-së deri me datë 26 mars 1999 dhe se kanë mbajtur shënime, kanë ditur emrat kush po merr pjese, prej cilit vend, kush është udhëheqës. Dëshmitari ka shtuar se edhe po të pyetej edhe një milion here do të deklaronte shumë i sigurt se me datë 28 Mars e ka parë fqinun e vet Z. Dj.

2.13. Dëshmitarja S. M. në dëshminë e saj dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: Në K. jeton që nga Qershori i vitit 1999, para kësaj ka jetuar në qytetin e P. me babain, nënën, motrën në ndërtesën ”...”, adresa ka qenë “...” numri nuk i kujtohej, ku në të njëjtin kat kishte jetuar edhe Z. Dj. me familje dhe i ka njohur ngase është shoqëruar me motrën e tijë J. dhe ka shkuar shpesh edhe në shtëpinë e tyre. I kujtohej se bombardimet e NATO kanë filluar me datë 24.03.1999 se në kohën e bombardimeve të NATO-së nuk e ka parë fare Z. Dj. në P., se disa ditë para bombardimeve e kishte takuar me babain e saj, dhe gjatë bisedës ai ka përmendur se planifikon të shkojë në B., duke i thënë babait të saj “*axha M. më mirë të shkoj në B. se po fillojnë bombardimet*”, kjo bisede është zhvilluar para banesës, se ajo bisede me të pandehurin është bërë afërsisht dhjetë ditë para bombardimeve, duke shtuar se asnjëherë pas asaj bisede më nuk e ka parë Z. në P. Më pas dëshmitarja ka shtuar se nuk e din saktë se Z. a ka shkuar në B. por e din se motra e tij J. shpesh e ka përmendur duke thënë “*shumë mirë që Z.i ka shkuar në B.*”, Meqenëse Z. e kishte komshi thekson se të njëjtin asnjëherë nuk e ka parë në uniformë apo më armë në dorë. Sa i përket personalitetit të tij ka theksuar se ai ka qenë fqinjë i mrekullueshëm e tërë familja ka qenë e njëjtë, Z. ka qenë djalë i qetë. I kujtohej se Z. është marrë me politikë por din se nuk ka qenë përkrahës i S. M. që për të njëjtën ka qenë diçka e çuditshme sepse ne atë kohë të gjithë ishin me S. Në një rast dëshmitarja thekson se me J. kanë shkuar deri në P. e P. që ajo ta telefonoj Z. në B. sepse aty kishte qenë mundësia e vetme me thirre dikën në Serbi. Dëshmitarja ka shtuar se e njeh edhe një Z. Dj. tjetër i cili ka pas një vajzë me emrin S. që ka qenë gjeneratë e saj, ata kanë jetuar anën tjetër të rrugës, ai Z. ka pas edhe dy fëmijë tjerë djalin S. dhe vajza e vogël J. dhe se ai personi tjetër i quajtur Z. Dj. ka qenë polic. Në vitin 1999 deklaroi se ka qenë gjashtëmbëdhjetë vjeçare, gjatë kohës kur janë bërë sulmet ajo ka qëndruar në strehimore pasi që kanë jetuar në katin e dhjetë, kanë zbritur poshtë dhe janë fshehur vetëm kur i kanë lajmëruar se kanë përfunduar bombardimet atëherë kanë dalë. Me sa i kujtohet Z.n Dj. pra vëllai i shoqes së saj në kohën sa ka qenë i ri ka pas vath në vesh. Data kur

është larguar nga P. ajo së bashku me familjen nuk i kujtohej por din se ka qenë muaji Qershor. Dëshmitarja ka shtuar se i pandehuri Z. Dj. ka studiuar në universitetin "...". Se komandant "M." për shqiptaret vetë emri i tij ka qenë i tmerrshëm, por nuk e din se çka ka bërë ai, atë nuk e ka parë vetëm ka dëgjuar ashtu, nuk e din as çfarë funksioni ka pas e as detyrën e tij. Dëshmitarja tutje në dëshminë e saj ka dëshmuar se kanë pas më herët raporte të mira me shqiptaret dhe ka pas një shoqe shqiptare E. që ka jetuar në katin e njëjtë me të. Se pas takimit që e kanë pasur me Z. para banesës, ku ishte prezent edhe babai i saj, ajo thekson se deri në ditën kur ka dhënë dëshmi para gjykatës nuk e ka pare asnjëherë. Dëshmitarja në fund ka shtuar se para se të vije në seancë është dëgjuar me J., dhe avokatin z. Lj. P. i cili e ka udhëzuar se si te sillej në gjykatë dhe si ta dëgjoj gjykatën dhe se instruksione tjera nuk ka marrë, por vetëm i është thënë se duhet me thënë vetëm të vërteten.

2.14. Dëshmitari I. C.c në dëshminë e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor mes tjerash ka dëshmuar se: në Kosovë ka jetuar nga 1 Tetori 1994 deri Tetor- Nëntor të vitit 1988, ka studiuar në universitetin "..." në P., provimin pranues e ka kaluar në Korrik ndërsa me 1 Tetor 1994 ka ardhur në Kosovë për të parën herë. Gjatë vitit të parë ka banuar në një banesë private me qira, pastaj vitin e dytë te qendra studentore. Fakultetin e ka përfunduar dhe ka diplomuar në vitin 2001 në Beograd sepse ka qenë gjendje lufte dhe se fakulteti e ka ndërruar selinë ne fund të vitit 1998 në fillim të vitit 1999. Se të pandehurin e njuh së pari si kolegë fakulteti, e pastaj gjatë studimeve dhe pas përfundimit të fakultetit e ka takuar. Ai ka jetuar në soliterin e lartë në rrugë për stacion të autobusëve, e din se ai e ka ndihmuar familjen e tij me atë çka ka punuar. Në atë kohë i pandehuri ka punuar në kafiterinë "... afërsisht në vitet 1994-1995. Se Z. Dj. dhe të gjithë që kanë studiuar në P. kanë vazhduar studimet në B. në universitetin "....." Fakulteti për Tregti dhe Bankë. Se Z. Dj. për herë të parë e ka parë në B. rreth Marsit te vitit 1999, sepse në Shkurt – Mars kanë filluar në atë kohë provimet dhe se i kujtohej se i pandehuri në atë kohë në B.d ka jetuar te disa kushëri. Se Z. e ka humb një vit por nuk i kujtohej cilin vit. Dëshmitari ka shtuar se kanë hyrë disa provime bashkë por nuk i kujtohej kur ka qenë hera e fundit që kanë hyrë në provim bashkë pasi kanë kaluar njëzetën vite, se ai për vete provimin e fundit në P. e ka dhënë në vitin 1998.

III. Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor:

- Procesverbali i identifikimit të personit përmes fotografisë (V. B.) PPPnr. 31/2017 të dt.26.02.2019- DHKR Sektori i Hetimeve të Krimeve të Luftës.
- Procesverbali i identifikimit të personit përmes fotografisë (M. Xh.).
- Procesverbali i identifikimit të personit përmes fotografisë (Sh. K.).
- Kopja e listës së datës 03.06.1999 e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – Sekretariati në P. nga Komandanti i Stacionit Policor Major – M. S.
- Shikimi i fotografive të pranuar nga KMDLNJ.
- Dëshmia e siguruar nga burimet e hapura që Ministria e Punëve të brendshme në vitin 1999 kishte publikuar pjesëtar policor të vrarë në vitin 1998 në Kosovë.
- Shkresa nga KMDLNJ.
- Shikimi i foto dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës.
- Kopja e ID kartelës së OSBE Misionit verifikues e periudhës 1998-1999
- Kopja e ID kartelës e Ministrisë për Bashkësi dhe Kthim e Qeverisë së RSK-së
- Kopja e ID kartelës ICITAP
- Kopja e ID kartelës e organizatës Danish Refugee Council
- Shikimi i fotografisë i shkrepur me dt 31.10.2012 me titull H. K. ka vizituar Kishën e Shën Nikollës në Prishtinë në cilën fotografi pranë Hi. K. e cila në kohën kur është

shkrepur fotografia ka qenë sekretare e departamentit Amerikan, e në cilën fotografi pranë saj gjendet edhe Z. D.

- Dy dokumente apo urdhëresa të Gjykatës së Qarkut në Pejë me numër HPQ.nr 140/2000 dhe shkresa HPQ.nr 2/2001 të cilat konsistojnë në dy urdhëresa me të cilat gjyqtari hetues i gjykatës së përmendur gjyqtari S. G. i ka lëshuar.
- Vërtetimi i dt.01.03.2019 i lëshuar nga fakulteti "..."
- Deklarata e dëshmitarit Sh. K. e dhëne me dt. 05.06.2000 KMLDNJ
- Në cilësinë e provës materiale komentet e bëra në rrjetet sociale nga tani i akuzuari, dhe atë 12 faqe të këtyre provave.

IV. Mbrojtja e të pandehurit

4.1. I pandehuri Z. Dj. në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: se ka dhënë dy deklaratat lidhur me këtë rast një në polici tjetër në prokurori, dhe me 01 Shkurt 2019 është arrestuar në kalimin kufitar në J. Citat *"jam nisur me djalin tim nga B. për në M., me që ka filluar pushimi dimëror, dhe ta kalojmë një kohë të caktuar me gjyshin dhe tezen në M., me babain tim dhe motrën time do të thotë. Kur kemi arritur në kalimin kufitar në J. ka hyrë policia dhe ka kërkuar letërnjoftimin e të gjithëve dhe i marrin të gjithëve dhe pastaj i verifikojnë, përafërsisht 15-20 minuta. Përsëri janë kthyer në autobus dhe e kanë thirrur emrin Z. Dj., unë jam paraqitur dhe ata më kanë nxjerr nga autobusi dhe më kanë quar në kontejnerin që është pjesë përbërëse e atij pikë kalimi dhe më kanë mbajtur aty. Unë kam kërkuar nga vozitësi të më pres se nuk e kam ditur si do të zhvillohet e tërë kjo sepse fëmija i moshës së mitur ka mbetur në autobus, megjithatë pas 10-15 minuta kam marr informatën që policët i kanë urdhëruar autobusin që të vazhdoj udhëtimin sepse unë do të qëndroj pak më gjatë aty, autobusi ka shkuar mua më kanë ndaluar aty. Brenda kontejnerit janë dy dhoma, mua më kanë vendosur në një dhomë ku kane qenë disa kompjuter dhe shtypës të vjetër, etj etj, ndërsa në anën e kundërt ka qenë një dhomë ku ka qëndruar një polic. Në atë moment unë kam qenë i lirë dhe nuk e kam ditur se çfarë është duke ndodhur por ka qenë e qartë se diçka po ndodhë, sepse një polic vazhdimisht ka qëndruar me mua, kam pas qasje edhe në telefon, ndërkaq në një moment kam kërkuar ta ndezë një cigare se brenda në objekt ka qenë e ndaluar dhe kam kërkuar të dal jashtë kontejnerit dhe më kanë lejuar. Kam dalur jashtë me ndezë një cigare dhe te dhomat nuk e di nëse kanë pas dere apo jo por dyert kane qenë të hapura, kam dëgjuar bisedën e policit i cili bisedonte me dikë dhe i thotë "por këtu qëndron personi Z. M. Dj. ndërsa ky është Z. M.ag Dj.*

I pandehuri më tej ka shtuar se ka jetuar në M. nga Korriku apo Gushti 1999 deri në vitin 2014 apo 2015, por që nuk ka jetuar vazhdimisht. Pas largimit nga P. ai dhe familja e tij kanë shkuar në S. ku kane qëndruar një apo dy muaj dhe pastaj nëna e tij e ndjerë është punësuar në M. dhe familja kanë shkuar atje, ndërsa i pandehuri ka mbetur edhe një muaj për ti kryer disa obligime rreth fakultetit, ku gjatë asaj kohe ka punuar në disa organizata vendore dhe ndërkombëtare OJQ dhe organizata qeveritare, një periudhë të shkurtër rreth një muaj ka punuar në Ministrinë për Kthim dhe Bashkësi Etnike. Pas asaj periudhe kohore ka punuar në Zyrën Administrative në M. V.

4.2. I pandehuri Z. Dj. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se para luftës në P. ka punuar kohë pas kohe si kamerier. Ka punuar edhe në OSBE si punëtor i sigurimit ku shef e kishte S. T. Sa i përket takimin e S. T. dy ditë para masakrës 29.03.1999 nuk i kujtohej, i kujtohet se me të njëjtin për herë të fundit është takuar në ndërtesën e OSBE në ndërrim të fundit apo një ndërrim më herët. I kujtohet se bombardimi në ish Jugosllavi kanë filluar me datë 24.03.1999. Se kohë më parë, para bombardimeve nëna e tij e ndjerë e ka pritur me thirrjen ushtarake duke qarë, atë natë

e ka kaluar në mendime dhe ka vendosur që të largohet nga Kosova, gjë që e ka bërë të nesërmen kur ka vendosur që të shkojë në B.

4.3. I pandehuri ka deklaruar se para fillimit të luftës në Kosovë ka pasur armë, se në vitin 1997 i kishte ardhur njoftimi se të gjithë personat që kanë përfunduar shërbimin ushtarak duhet të paraqiten për tu ngarkuar me armë dhe atëherë është ngarkuar me pushkë automatike me njëqindnjëzet fishek, dhe se atë pushkë e ka marr nga Mbrojtja Territoriale, e cila në njohurit e tija kishte qenë pjesë e ushtrisë. Pushkën e kishte lënë tek vendi ku linin drunjtë dhe më pastaj kurrë nuk e ka parë atë pushkë dhe ata fishek. Axha i tij që jeton në B. quhet M. Dj. ku edhe i pandehuri kishte qëndruar te ai dhe se atje kishte shkuar nga frika e mobilizimit dhe se me datë 24 Mars kishin filluar bombardimi i Serbisë nga ana e NATO-së dhe kishte ndodhur një kaos dhe aty askush nuk shikonte.

4.4. I pandehuri gjatë paraqitjes së mbrojtjes së tij më tej ka shtuar, citat *“në marrëveshje me prindërit e mi unë kam dashur shumë para kësaj të vij nga B. që ti marrë prindërit e mijë dhe shumë para kësaj me dalë nga P., mirëpo ata kanë insistuar që të mos vijë duke më thënë se ka kontrolla të mëdha, në hyrje – dalje, e mos te arrestohem për shkak të dezertimit, ndërsa me dt.12 kam vendosur të kthehem jam marrë vesh edhe me familjarët, ju kam thënë se më nuk pres, se do të vijë për ti marrë. Në atë kohë nga disa pjesë kanë filluar të tërhiqen edhe ushtria edhe populli, gjegjësisht populli serb, e kam kuptuar këtë si rrezik për ata, kam ardhur me një mik i cili është i P., i cili gjithashtu në kohë lufte ka qenë në B. P. dhe së bashku kemi ardhur me veturë për ti marr të tonët, ai e ka pas vetëm nënën, kemi mund të marrim me mend që babai nuk do të vjen do të rrijë, dhe që vjen vetëm nëna ime, Kështu që me datë 13 në mëngjes në ora 5 jemi nisur nga K. për në R. e pastaj në S.”.*

4.5. I pandehuri ka shtuar se pas luftës ka shkuar në P. dhe për herë të parë pas luftës është kthyer në vitin 2000 apo 2001, se nga P. paraprakisht është larguar për shkak se nuk ka qenë dakord me politikën e M., disa nga arsytet kane qenë luftërat në Bosnjë e Kroaci, mënyra e sjelljes ndaj popullit në Serbi dhe kriza ekonomike. Se kur ka shkuar nga P. në B. thekson se edhe atje ka pas bombardime, por nuk i kujtohet sakte dita kur e ka lëshuar Pejën por është në njohuri se bombardimet kanë filluar me 24 Mars dhe ai para 24 Mars ka qenë në Beograd afërsisht katër - pesë apo dhjetë ditë më herët. Fakultetin “...” e kishte regjistruar në vitin 1993, me ligjërata ka përfunduar afërsisht Tetor 1998, dhe në Tetor i ka filluar stazhi absolut. Se fakulteti në të cilin ka studiuar prej P. është zhvendosur në B. rreth vitit 1997- apo 1998, dhe se nuk ka vijuar studime të rregullta në vitin 1998 në B., ndërsa në Tetor ka dhënë provimin e diplomës të vitit 1999.

Gjithashtu ka shtuar se gjatë kohës që ka qëndruar në P. nuk ka pas konflikt të armatosur, i kujtohej se në Dhjetor të vitit 1998 ka ndodhur vrasja në kafiqin “...” e cila datë e saktë nuk i kujtohej. Në Ministri ka punuar prej vitit 2005 deri 2007, paraprakisht për atë vend pune është paraqitur në Zyrën Administrative për konkurs, intervistën e ka pasur në Prishtinë në Qeverinë e Kosovës, ku më pas ka kuptuar nga koleget që janë verifikuar në atë kohë.

4.6. Sa i përket vizitës në P. në vitin 2014 -2015 thekson se ftesën e ka pranuar nga S. Ll. përmes Facebook, duke kërkuar që të takohemi lidhur me shitblerjen e banesës së tij dhe duke kaluar njëherë në atë pjesë të qytetit të njëjtin e kishte parë duke qëndruar para lokalit, kishin shkuar së bashku në Hotel “...”, ku kolegu i tij që e kishte pas me vete ishte ulur një tavoline tjetër me miqtë e tij, ndërsa i pandehuri ishte ulur me z. Ll. duke biseduar në lidhje me banesën.

I pandehuri krejt në fund ka deklaruar, citat *“më vjen keq nuk e kam pritur që do të krijohet një situatë e tillë kësisoj, ka ndodhur kjo që ka ndodhur për çka jam i akuzuar, unë me të vërtet nuk*

e kam bërë këtë e as që do të mundja ndonjëherë të bëja kështu diçka pa marr parasysh se sa këtu ndoshta disa shaka të mija që mund ti quajmë ashtu disa slogane të tifozëve të merren si matëse të asaj kush jam dhe çka jam. Po më vjen keq shumë për shkak të kësaj dhe kjo është e tera nuk kam tjetër çfarë të shtoj”.

-V. Fjala përfundimtare e palëve

5.1. Prokurorja nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës H. S. fjalën përfundimtare e ka dorëzuar në formën e shkruar² dhe të njëjtën e ka elaboruar në shqyrtimin gjyqësor, ku mes tjerash ka deklaruar; *se duke u bazuar në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor pa mëdyshje është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri përveç veprimeve inkriminuese që janë të përshkruara si në aktakuzën PPS.nr.23/2018 e dt.31.05.2019, i njëjti ka ndërmarr veprime tjera inkriminuese ashtu që duke bashkëvepruar me personat siç janë cekur në akuzë, në lagjen “...” të P. ka marrë pjesë në aksionin që kishte filluar me vrasjen dhe dëbimin e qytetareve shqiptar nga shtëpitë e tyre. Po ashtu duke u bazuar në provat e administruara është vërtetuar se i pandehuri me datë 28.03.1999 ka kryer edhe një vepër të njëjtë penale, duke paraqitur me dt.08.01.2021 në gjykatë me aktakuzën e ndryshuar si dhe të zgjeruar. Gjithashtu ka theksuar se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri përbënë vepër penale, nuk ka ndonjë rrethanë që e përjashton të njëjtin nga përgjegjësia penale, se vepra penale nuk është parashkruar, nuk është përfshirë në falje apo amnisti, duke propozuar që gjykata të ketë parasysh gjitha rrethanat e kryerjes së veprës penale, duke marr për bazë edhe faktin se i njëjti asnjëherë nuk është penduar për veprat e kryera, asnjëherë nuk ka kërkuar se paku falje të dëmtuarve, nuk ka shprehur keqardhje, dhe në fund kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.*

5.2. Përfaqësuesi i palëve të dëmtuara av. K. K. fjalën e tij përfundimtare e ka dorëzuar në formë të shkruar³, të njëjtën e ka elaboruar, ku ka bërë një analizë të thellë dëshmime të dëshmitarëve dhe provave materiale, ka vënë në pah mospërputhjen në mes të deklaratave edhe të dëshmitarëve të mbrojtjes edhe vet të pandehurit. Në fjalën e tij përfundimtare ka bërë plotësimin e kërkesës për kompensim të dëmit, për z. M. Xh. dhe z. A. N. në vlerë prej 100 mijë euro për secilin dhe ka shtuar se sa i përket kërkesës pasurore juridike për të dëmtuarit të tjerë ka qëndruar pranë atyre të saktësuar duke i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta detyroj që ne emër të kompensimit të dëmit të paguaj vlerën 100,000.00 euro për familjen e të ndjerit H. Z. 200,000.00 euro për familjen e të ndjerit S. Z., 200,000.00 euro, për familjen e të ndjerit B., 200,000.00 euro, për familjen e të ndjerit M., 100,00.00 euro, për familjen H., 100,000.00 euro për familjen H. dhe 100,000.00 euro për Fondin e Viktimave të Krimit dhe ka shtuar se është i vetëdijshëm se nuk ka shumë monetare që shpague humbjet e familjareve.

Përfaqësuesi i palëve të dëmtuara tutje ka theksuar se i pandehuri është kryerës dhe pjesëmarrës aktiv në kryerjen e veprave penale, se të dëmtuarit përveç të pandehurit kanë identifikuar edhe persona të tjerë që kanë marr pjesë në krimet e kryera në kohën dhe vendin e përshkruar si në aktakuzë. I njëjti mes tjerash gjithashtu ka theksuar se në Republikën e Kosovës janë më shumë se 14,000.00 viktima të vrara nga gjitha etnitë dhe krejt në fund ka propozuar që gjykata të merr aktgjykim me të cilin të pandehurin Z. Dj. ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim meritot.

5.3. Mbrojtësi i të pandehurit av. Lj. P., fjalën përfundimtare e ka dorëzuar në formën e shkruar⁴ dhe e ka elaboruar në shqyrtimin gjyqësor. Në fjalën e tij përfundimtare mbrojtësi i të pandehurit

² Shih fjala përfundimtare e Prokurores së Shtetit

³ Shih fjala përfundimtare e përfaqësuesit të palëve të dëmtuara av.Kujtim Kërveshi

⁴ Shih fjala përfundimtare e mbrojtësit të pandehurit av.Ljubomir Pantovic

ka theksuat se aktakuza e cila ka qenë objekt i shqyrtimit nuk është e bazuar në prova të besueshme dhe si e tillë nuk mund të jetë bazë për një aktgjykim dënues. Mbrojtja ka paraqitur vërejtjet e saj në kualifikimin juridik të veprës penale nga ana e prokurorisë, por edhe në ndryshimin dhe zgjerimin e akuzës. Mbrojtja e të pandehurit më pas sa i përket gjendjes së fakteve të vërtetuar pas shqyrtimit gjyqësor ka potencuar se nuk pajtohet me prokurorinë, pasi që sipas mbrojtjes nuk dëshmitë e dëshmitarëve e prokurorisë dhe palës së dëmtuar nuk kanë qenë bindëse e as të vërteta. Po ashtu mbrojtja ka paraqitur disa argumente duke e konsideruar prokurorinë si të anshme pasi sipas saj nuk janë propozuar disa dëshmitarë që kanë dhënë deklaratat në procedurë paraprake, e që sipas mbrojtjes këto dëshmi do të ishin si prova shfajësuese për të mbrojturin e tij.

5.4. Mbrojtësi i të pandehurit Z. Dj. av. Lj. P. më tutje ka potencuar në fjalën e tij mbrojtëse se ka mospërputhje në deklaratimet e të dëmtuarës V. B., po ashtu ka bërë vërejtje në deklaratat e të dëmtuarit Sh. K., duke i elaboruar ato dhe duke i vënë në dukje mospërputhjet. Lidhur me alibin e të pandehurit mbrojtja ka cituar një pjesë të aktgjykimit IT-98-32-A të Gjykatës Ndërkombëtare për ish Jugosllavi e cila thotë;” kur i pandehuri thirret në alibi ai nuk është i detyruar që ta dëshmojë se alibi është i vërtetë. Barra e provës është tek prokuroria dhe gjithmonë qëndron tek prokuroria”. Mbrojtja ka pasur vërejtje edhe tek identifikimi dhe lidhur me këtë ka dhënë argumentet e saj dhe në fund ka kërkuar që i pandehuri Z. Dj. të lirohet në akuza.

5.5. I pandehuri Z. Dj. në fjalën përfundimtare ka deklaruar, citat “*unë në tërësi e përkrahë fjalën e avokatit tim mbrojtës dhe dua të shtoj që nga fillimi i këtij rasti prokuroria është duke përdorur manipulime, kur e them këtë kam parasysh atë që u tha sot, që dikush që ka fol diçka të shpikur sipas emrit, mbiemrit të dhënave të tjera që janë përmendur, këto të dhëna të emrit, mbiemrit, adresa vazhdimisht manipulohet me këto të dhëna. Unë jam i përgatitur për fjalën përfundimtare sot, duke veçuar fjalën e prokurores dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar doli se nuk kam pas nevojë të përgatitem fare, sot pas aq shume spekulimeve dhe manipulimeve kjo është e pa besueshme. Nëse vihet këtu dhe thuhet që ekziston një Z. Dj. tjetër kjo vlen e pa vërtet, nëse thuhet se dy numra nga letërnjoftimi i vjetër i RFSJ-së plotësisht përputhen dhe nuk mund të behet gabim ajo duhet të merret si një e vërtet dhe askund nuk kemi pare që ata dy numra po përputhen. Unë me siguri dhe në mënyrë absolute nuk po përpiqem të zvogëloj dhimbjen dhe vuajtjen e askujt as të përqesh askënd megjithatë behet fjala për atë se këtu në mënyrë të vazhdueshme siç thash po manipulohet në disa gjëra. Do të përmendi një shembull; Unë po të isha “supermen” unë me datë 28 nuk do të kisha mundur të arrij që ta dëboj zotërinë e përmendur, ti ndërroj rrobat dhe ta takoj zonjushën M., dhe mbi të gjitha me uniforme, pa uniforme, te blej buke, te kthehem në shtëpi dhe të nesërmen të vazhdoj, thjeshte e pa mundur ti beje gjitha këto.*

Plotësisht pajtohem me atë çka tha mbrojtësi im, do të ishim jo normal të kisha bërë 1 % të asaj që po me vihet në barrë, ai person kurrë nuk do të kthehej në Kosovë, dhe ne do të marrim si provë atë që në atë kohë nuk kanë qenë të nevojshme verifikimet dhe kjo do të thotë që është e vërtetë, a po.

VI. Gjetjet e Gjykatës.

6.1. Gjykata pas procedurës së provave, analizimit të tyre, secilës veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, e ka vërtetuar gjendjen e fakteve si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Këtë gjendje të fakteve gjykata e ka vërtetuar në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve dhe provave materiale të

cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, duke nxjerrë përfundime se faktet konkrete janë provuar, lidhur me veprën që i është vënë në barrë të pandehurit.

Gjykata arsyetimit të këtij aktgjykimi do filloj nga baza ligjore sipas ligjeve në fuqi në kohën e kryerjes së krimit, si dhe analizimit të konventave ndërkombëtare kundër krimeve të luftës.

6.2. Bazuar në nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e cila dispozitë përcakton Krimet e luftës kundër popullatës civile përcakton: kush duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare gjatë luftës, të konfliktit të armatosur ose të okupacionit urdhëron që kundër popullatës civile të bëhen vrasje, tortura, sjellje çnjerëzore, eksperimente biologjike, shkakim të vuajtjeve të mëdha ose cenim të integritetit truporë apo të shëndetit; shpërngulje ose transferime apo çkombtarizime me dhunë ose kthim në ndonjë fe tjetër; shtrëngime për t'i marrë me prostitucion ose kryer dhunime seksuale; aplikimin e masave të frikësimit dhe terrorit, marrjen e njerëzve peng, ndëshkime kolektive, dërgimin në kampet e përqendrimit dhe kryen mbyllje të tjera të kundërligjshme, privimin e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm; shtrëngime për të shërbyer në forcat e armatosura të fuqisë armike ose në shërbimin e saj informativ ose në administratën e saj; shtrëngime për të bërë punë të detyrueshme, lënien popullsisë në uri, konfiskime të pasurisë, grabitje të pasurisë së popullsisë, asgjësimin e kundërligjshëm dhe arbitrare apo përvetësime në përpjesëtime të mëdha të pasurisë që nuk arsyetohet me nevojat ushtarake, merr kontribute dhe kryen rekuizime të paligjshme e në përpjesëtime të mëdha, kryen uljen e vlerës së parave të vendit ose emetimin e kundërligjshëm të parave, ose kush kryen ndonjë nga veprat e lartpërmendura do të dënohet me të paktën me pesë vjet burgim ose dënim me vdekje.

6.3. Shkelje e rëndë e nenit 3 të përbashkët të katër konventave të Gjenevës të 12 gusht 1949 do të thotë një ose më shumë nga veprimet e më poshtme të kryera në kontestin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtarë kundër personave që marrin pjesë aktive në armiqësi, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër;

- Dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura,
- Kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi nënçmues,
- Marrja e pengjeve
- Shqiptimi i dënimit dhe kryerja e ekzekutimeve pa aktgjykime paraprake të shpallura nga një gjykatë e rregullt që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të cilat përgjithësisht njihen si të domosdoshme.

6.4. Protokollin Shtesë II, i 8 qershorit të vitit 1977 është një hap më tutje i bërë për mbrojtje në luftërat që përfshin forcat e armatosura disidente apo grupe të tjera të organizuara të armatosura, të cilat nën një komandë të përgjegjshme, ushtrojnë kontroll mbi një pjesë të territorit. Në nenin 4 të këtij protokollin garantohen të drejtat fundamentale të njeriut, ndërsa në nenin 5 përcaktohen të drejtat e personave liria e të cilëve ka qenë e kufizuar.

Pra në bazë të ligjeve që kanë qenë në fuqi në kohën e luftës në Kosovë, dhe Konventave Ndërkombëtare, konkludohet se krimet e luftës kundër popullatës civile mund të kryhen gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit. Viktima sipas këtyre akteve ligjore vendore dhe ndërkombëtare, apo objekti i mbrojtur me ligj dhe konventa ndërkombëtare janë kryesisht popullata civile, por mund të konsiderohen edhe pjesëtarët e forcave të armatosura të cilët i kanë dorëzuar armët dhe janë dorëzuar dhe personat e plagosur apo të sëmurë.

Krime Luftë kundër popullatës civile sipas nenit 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, në shkelje të nenit të përbashkët 3 të Konventës së Gjenevës të 12 Gusht 1949 dhe në shkelje të nenit 4 të Protokollit 2 të 8 Qershorit 1977, mund t'i kryej kushdo që shkelë rregullat dhe zakonet e luftës, pra nuk kërkohet që kryesi domosdoshmërisht ti përkas ndonjë formacioni të caktuar ushtarak apo paraushtarak apo çfarëdo formacioni tjetër.

6.5. Nuk është kontestuese se viktimat tani të ndjerët H. Z.j, S. Z., B. B. dhe R. M. janë gjetur në një varrezë masive në B. në Republikën e Serbisë.

Lidhur me datën kritike, fillimisht 28 mars të vitit 1999 në lagjen “...” tani “...” në Pejë, pastaj edhe me datë 29 mars të vitit 1999, në Lagjen “...” në P., në bazë të dëshmive të dëshmitarëve është vërtetuar se pas fillimit të bombardimit të caqeve të ushtrisë dhe policisë serbe si dhe forcave paramilitare nga aleanca ushtarake NATO, e të cilat kishin filluar me datë 24 mars 1999, në qytetin e P. konkretisht edhe në këto dy lagje kishte filluar një fushatë e spastrimit etnik, të cilën dëshmitarët e kanë përshkruar, pasi që të gjithë nga këta dëshmitarë janë larguar dhunshëm nga shtëpitë dhe banesat e tyre për shkak të përkatësisë së tyre etnike shqiptare, duke përfunduar si refugjatë kryesisht në Malin e Zi.

6.6. Nga dëshmia e dëshmitares – së dëmtuarës M. Z. gjykata e vërtetoi faktin se me datë 29.03.1999 në qytetin e P., më saktësisht në lagjen “...” deri sa dëshmitarja ishte me burrin e saj tani të ndjerin S.r Z., së bashku me këtë familje ishte edhe kunati i saj tani i ndjeri H. Z. me familje dhe Sh. K. me familje. Pra këto tre familje me të filluar krizat e armëve nga forcat serbe, kishin menduar që të bashkohen, për tu strehuar në bodrumin e familjes së të dëmtuarës M. dhe këtë e kishin bërë nga frika se do t'i ndodhte më e keqja. Nga dëshmia e kësaj dëshmitareje gjykata e vërtetoi faktin se pasi që këto tre familje kishin qëndruar në bodrum për rreth dy ore, forca të armatosura serbe kishin hyrë dhunshëm në shtëpinë e tyre duke i urdhëruar në gjuhen serbe “ e dimë që jeni në bodrum, dilni se do t'ju kallim të gjallë.” Nga dëshmia e të dëmtuarës – dëshmitares M. Z. gjykata e ka vërtetuar faktin se forcat e armatosura serbe pasi që i kishin ndarë burrat nga gratë dhe fëmijët, kishin plaçkitur pasurinë e tyre si të holla dhe arë, me pas i kanë dëbuar që të gjithë me dhunë nga shtëpia e tyre duke i drejtuar në drejtim të shtëpisë së A. M., ku po qëndronin disa forca serbe të armatosura, të cilat e kanë ndaluar S. dhe Sh., ndërsa dëshmitarja me familjarë të tjerë janë dëbuar tutje në drejtim të Malit të Zi, ndërkohë që shtëpia e saj ishte djegur. E dëmtuara që nga ajo kohë nuk e ka parë më burrin e saj, vetëm pas luftës ka kuptuar se ai është vrarë.

Dëshmia e dëshmitares – së dëmtuarës M. Z. e cila është dëshmitare e drejtpërdrejtë e krimeve të luftës që kanë ndodhur, është e një rëndësie të veçantë në lidhje me këtë çështje penale, ngase në bazë të dëshmisë së saj gjykata ka mundur që t'i vërtetoj disa fakte që janë të rëndësishme për

figurën e veprës penale Krimet e luftës kundër popullatës civile si; vrasje, tortura, sjellje çnjerëzore, shkaktim të vuajtjeve të mëdha, cenim të integritetit trupor apo të shëndetit dhe shpërngulje me dhunë. Po ashtu kjo dëshmitare ka dëshmuar se ditën kritike e ka parë V. B. duke qarë me zë të lartë që në lidhmëni me provat e tjera është e rëndësishme për veprën penal, por edhe për identifikimin e të pandehurit Z. Dj. si njëri nga kryesit, ashtu siç është i rëndësishëm edhe thënia e saj se në mesin e popullsisë së shpërngulur dhunshëm është dëgjuar emri Z. si pjesëmarrës në krim.

6.7. Nga dëshmia e dëshmitares – së dëmtuarës L. Z. e cila dëshmi është në përputhmëni të plotë me dëshminë e dëshmitares M., gjykata i ka vërtetuar faktet vendimtare lidhur me ditën kritike, që nga strehimi në bodrum, ndarja e burrave nga gratë dhe fëmijët, plaçkitja e pasurisë së tyre, shpërngulja me dhunë nga shtëpia, deportimi i tyre për na Malin e Zi, marrja e informatës nga një person së bashkëshortin e saj e kanë vrarë, gjersa sa kjo ishte e shpërngulur në U. i cili i kishte treguar edhe emrin Z. dhe në fund mbërritja e mbetjeve mortore e të ndjerit H. Z. nga varreza masive në B. Republika e Serbisë. Dëshmia e kësaj dëshmitare është e rëndësishme edhe për faktin se e konfirmon prezencën edhe të dëshmitarëve tjerë në krim, sikurse janë anëtarët e tre familjeve që ishin strehuar fillimisht në bodrum, por edhe prezencën e V. B. ditën e krimit.

6.8. Nga dëshmia e dëshmitares V. B. gjykata e ka vërtetuar faktin se ditën kritike e njëjta ishte duke qëndruar më shtëpinë e tyre së bashku me prindërit dhe vëllaun tani të ndjerë B. B. dhe me të dëgjuar dhe parë se po afroreshin forcat e armatosura serbe ishte futur nga rrugica e lagjes për në shtëpi duke i thënë B. që të largohet, e i cili kishte hezitur dhe kishte hyrë brenda shtëpisë dhe në momentin kur dëshmitarja kishte hapur portën e derës së oborrit të shtëpisë kishte hasur në një gryke të automatikut të cilin po e mbante një person i uniformuar i cili e kishte detyruar që të shtrihet në toke dhe nga frika se vëllaut të saj do t'i ndodhte më e keqja i kishte bërë thirrje vëllaut të saj Ba. që të mos dal nga shtëpia, ku më pas personat e armatosur e kishin pyetur se kush është brenda në shtëpi ndërsa kjo i kishte thënë së është vëllau i saj dhe i kishte lutur që mos ta rrëmbenin, por që atë pra B. e kishin nxjerrë forcërisht nga shtëpia dhe e kishin futur në oborrin e shtëpisë së fqinjit të tyre H. Po ashtu edhe kjo dëshmitare ka dëshmuar se ajo me familjen e saj pra babin dhe nënën kishin marrë rrugë të urdhëruar nga personat e armatosur që të largohen nga shtëpia fillimisht pa e ditur destinacionin e tyre dhe me të arritur tek shkolla “...” një grup i personave të nacionalitetit serb i kishte kthyer nga kishin ardhur dhe në kthim e sipër me të shtëpia e A. M. duke kërkuar vëllau e saj kishte hyrë në oborrin e kësaj shtëpie, kishte parë një person me rroba ngjyrë kafe të vrarë i cili kishte qenë në pozicion të shtrirë ashtu siç e përshkruan dëshmitarja përmbys. Sipas dëshmitares ajo ka pasur frikë që të shikoj edhe me tutje dhe kishte dalë nga shtëpia e A. M., por pas tre orëve kur në ikje e sipër kishin shkuar tek një shtëpi e nacionalitetit Boshnjak nga disa persona që kanë ardhur në atë shtëpi kishte kuptuar se B., S., H. dhe një person tjetër, i kishin vrarë mu në shtëpinë e A. M. Këtë fakt ia kishte vërtetuar edhe një person i nacionalitetit serb të cilin e kishte lutur që të shkoj të shikoj, edhe i njëjti ja kishte konfirmuar se katër persona janë vrarë në atë vendngjarje por pa i thënë emrat e tyre, e që në fakt për dëshmitaren kishte qenë e qartë se në mesin e tyre ishte e vëllai i saj dhe deri te ky konkluzion kishte arritur në bazë të rrjedhës së ngjarjes ditën kritike.

Dëshmia e kësaj dëshmitareje është e rëndësishme shumë të madhe në identifikimin e të pandehurit Z. Dj. si pjesëmarrës në krimet e luftës dhe atë tek dera e shtëpisë së saj duke komunikuar me

atë, në mënyrën e përshkruar më lartë, pra duke iu lutur që mos t'a rrëmbenin vëllanë, duke i përshkruar si dy persona të uniformuar, duke i parë mirë në fytyrë, ndërsa fytyra e të pandehurit Z. i ka mbetur në memorie në bazë të fytyrës, syve të tij dhe flokëve, por që më herët nuk e ka njohur dhe se emrin e tij e ka dëgjuar për herë të parë tre orë pas krimit në shtëpinë e komunitetit Boshnjak ku ishin strehuar. Të pandehurin Z. Dj. e ka përshkruar si personin që i ka rrëmbyer vëllaun B. Po ashtu edhe kjo dëshmitare ka dëshmuar se janë shpërngulur me forcë në Malin e Zi, pas disa ditëve të qëndrimit në shtëpinë e bashkëqytetarit të tyre të komunitetit Boshnjak, i cili i kishte lutur që të largohen nga aty ngase mund t'i bëjnë problem forcat serbe pasi kishin strehuar persona të zhvendosur të komunitetit Shqiptarë.

Dëshmia e kësaj dëshmitareje është në përputhje të plotë me dinamikën e ngjarjes kriminale ditën kritike, e cila dinamikë është përshkruar nga pothuajse të gjithë dëshmitarët, pasi që të gjithë ishin banorë të njëjtës lagje.

6.9. Nga dëshmia e dëshmitarit – të dëmtuarit Sh. K. gjykata ka vërtetuar faktin se ditën kritike i njëjti ishte detyruar që të largohet nga shtëpia e tij dhe se kishte shkuar tek shtëpia e të ndjerëve S. dhe H. Ze., ishin strehuar në bodrumin e shtëpisë së tyre, ku me të arritur forcat e armatosura serbe aty me urdhrin e tyre ishin detyruar që të dalin nga aty. Po ashtu njëjtë edhe ky dëshmitarë në mënyrë identikë si dëshmitaret M. dhe L. ka dëshmuar lidhur me ndarjen e burrave dhe grave me fëmijë, lidhur me plaçkitjen e pasurisë së tyre, rrahjet që i kanë bërë dhe zhvendosjen me dhunë nga shtëpia. Dëshmia e këtij dëshmitari është shumë e rëndësishme për vërtetimin e fakteve vendimtare për ekzistimin e veprës penale, pasi që është dëshmitarë i drejtpërdrejtë i vrasjes të fillimisht H. Z., i cili ka përshkruar se si tani i ndjeri H. kishte pasur një bisedë me vrasësin e tij ku ky i fundit i kishte thënë nga po të njoh, i ndjeri ia kishte kthyer se së bashku me Z. keni ardhur dhe keni pirë birra në lokalin e tij dhe sipas dëshmitarit në atë moment e ka goditur me breshëri automatiku. Ky dëshmitarë ka dëshmuar edhe rrugëtimin prej shtëpisë së H. i cili ka mbetur i varur në oborrin e shtëpisë së tij e deri tek shtëpia e A. M. Këtë rrugëtim e ka bërë së bashku me S. dhe B. i cili kishte qenë i rrëmbyer në shtëpinë e tij dhe në momentin kur këta dy kanë dalë në rrugice kanë hasur në atë, e që në afërsi ishin edhe paramilitarët siç i ka përshkruar dëshmitari, të cilët rrinin në një distancë pesë deri shtatë metra larg. Nga dëshmia e këtij dëshmitari gjykata e ka vërtetuar faktin se personi që i ka varur S. dhe B. ka qenë pozicionuar aty tek shtëpia e A. M., dhe i ka ndaluar që të tre pra S., B. dhe dëshmitarin Sh. K., pra ky nuk ishte person i cili po i shoqëronte gjatë rrugës, apo person që kishte qenë në shtëpinë ku ishin strehuar. Ky dëshmitarë ka përshkruar në hollësi se si janë varur S. fillimisht e pas tij edhe B. dhe ka mundur që të shohë edhe pjesët e trupi ku janë goditur me breshëri automatiku. Pasi që në mënyrë të pashpjegueshme i dëmtuari i kishte shpëtuar ekzekutimit kishte qenë dëshmitarë edhe i një vrasje, asaj të R. M. i cili ishte ekzekutuar vetëm sepse kishte qëlluar rastësisht në rrugë, pra ishte nisur që t'a dërgoj një bagëti tek kushëriri i tij.

Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit Sh. K. është dëshmi autentike, me të cilën provohet vuajtjet dhe tmerri që kishin përjetuar familjet shqiptare ditën kritike, duke i ju nënshtruar dhunës ekstreme fizike e psikike, shpërnguljeve masive nga shtëpitë e tyre, djegja e shtëpive të tyre dhe vrasjet e popullatës të paarmatosur civile, vetëm e vetëm se i përkisnin nacionalitetit shqiptar. Dëshmitari S. po ashtu është dëshmitari i parë që ka dhënë dëshmi me dt. 05.06.2000 pranë KMLDNJ-së.

6.10. Edhe nga dëshmia e dëshmitarit M. Xh. gjykata e ka vërtetuar faktin se ditën kritike V. B. kishte qenë para derës së shtëpisë së saj duke qajtur, pra kjo dëshmi përputhet me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë. Për gjykatën është relevante edhe dëshmia e tij lidhur me identifikimin e personit – ushtarit të armatosur i cili pasi që ky ishte detyruar nga një ushtarë tjetër që të jap të holla, kur ja kishte zgjatur që t’ia jap, i kishte thënë ‘Merri partë dhe shko përpjetë se të duhen’ dhe këtë ushtarë, pjesëtarë të armatosur e ka identifikuar si bjond me sy të kaltër. Po ashtu nga dëshmia edhe këtij dëshmitari gjykata ka vërtetuar faktet relevante për ekzistimin e veprës penale Krime Luftë, e që në rastin e dëshmitarit ishin shumë specifike, pasi që ai dhe bashkëshortja ishin ndarë nga fëmijët e tyre të moshës së vogël, me të cilët ishte takuar në R. të Malit të Zi vetëm pas një jave, e të cilët fëmijë deri atje kishin arritur në këmbë, ndërkohë që dëshmitari gjatë kësaj kohe kishte menduar se fëmijët i janë vrarë, sikur që edhe fëmijët e tij kishin menduar që i janë vrarë prindërit, gjë kjo që tek të dyja palët kishte shkaktuar vuajtje të mëdha.

6.11. Përmes dëshmisë së dëshmitarit F. M. djali i të ndjerit R. M., është vërtetuar fakti se i ndjeri R., ditën kritike kishte qenë i strehuar së bashku me familjen e tij në një shtëpi në një lagje tjetër, sepse paraprakisht kishin qenë të detyruar që ta lëshonin shtëpinë e tyre, shkak i dhunës dhe represionit të forcave serbe dhe një moment babai i tij i ndjerë ka dalë nga shtëpia, e që sipas dëshmitarit me nga ajo kohë nuk është takuar me atë, sepse dëshmitarin së bashku me anëtarët e tjerë të familjes i kishin përzënë forcat serbe edhe nga aty, ndërsa mbetjet mortore të R. M. ishin gjetur në vitin 2005 në një varrezë masive në B. të Republikës së Serbisë.

6.12. Dëshmia e dëshmitarit L. H. i cili është dëshmitarë i mbrojtjes është relevante për gjykatën për shpjegimin e dinamikës së ngjarjes që ka të bëjë me krimin e ndodhur dhe është mbështetje e dëshmive të dëshmitarëve të tjerë të drejtpërdrejtë, që lidhet me krimet e kryer ditën kritike, si zhvendosja me dhunë, plaçkitja e pasurisë, masat e frikësimit dhe terrori i ushtruar ndaj popullatës së pa armatosur të nacionalitetit shqiptar, deri të plagosja e dy djemve të tij, njëri nëntë dhe tjetri tre vjeçar në atë kohë. Dëshmia e tij e konfirmon edhe dëshminë e dëshmitarit Sh. K. dhe dëshmitarëve të tjerë lidhur me prezencën e tyre ditën e krimit në skenën e krimit. Po ashtu ky dëshmitarë e konfirmon edhe ndalimin e S. Z., B. B. dhe Sh. K. tek shtëpia e A. M., më pas e konfirmon edhe prezencën e R. M. të cilin e përshkruan si një person me kolicë dhe me një dele për kurban, të cilin dëshmitari e ka parë të gjallë, në një moment ka dëgjuar krisma nga të cilat ishte vrarë S. dhe B. dhe në fund tregon momentin kur Sh. i ishte bashkuar kolonës së të shpërngulurve dhunshëm, pasi që e kishin liruar forcat serbe. Pra kjo dinamike e ngjarje është në përputhje të plotë me atë që kanë dëshmuar dëshmitarët e tjerë, e në veçanti për shkak të detajeve është identike me dëshminë e dëshmitarit Sh. K.

6.13. Dëshmitari F. H., dëshmitarë i mbrojtjes po ashtu ka dëshmuar për ditën kritike, pra është dëshmitarë i drejtpërdrejtë i aksionit të forcave serbe në lagjen “.....” të P. Dëshmia e këtij dëshmitari është e rëndësishme për çështjen penale, në disa aspekte, ngase dëshmitari ka dhënë një dëshmi ku përshkruan dhunën dhe ndjekjen e forcave serbe për ti vrarë popullatën civile, konkretisht tentativën për ta vrarë dëshmitarin dhe dajën e tij, ngase të njëjtit ishin gjuajtur me pushke automatike. Për gjykatën dëshmia e këtij dëshmitari ka qenë e rëndësishme edhe për një element, ngase dëshmitari gjatë fshehjes së tij në kulmin e shtëpisë së tij i cili ka qenë një kulm i përkohshëm dhe në anët e tij kishte dërrasa nga mund të shihej oborri i shtëpisë, pasi shtëpia ishte njëkatëshe, dhe nga vrimat e dërrasave ka mund me e parë të pandehurin Z. Dj. në oborrin

e shtëpisë, me ç'rast i ka përshkruar edhe karakteristikat fizike të tij. Këtë dëshmi e përforcon edhe më shumë fakti se ky dëshmitarë ka qenë në gjendje që të dëgjoj edhe radiolidhjet e këtyre personave të armatosur dhe të uniformuar, pra ka qenë në një distance që ia ka lejuar këtë duke thënë “Z. ima li neshto tamo” apo në shqip “Z. a ka diçka atje” e që për gjykatën është shumë e qartë që Z. është shkurtesë apo emërim Z.

6.14. Nga dëshmia e dëshmitarit të mbrojtjes A. N., e cila dëshmi ka të bëjë me ngjarjen e datës 28 Mars të vitit 1999 në lagjen “....” që tani quhet “...” në P., gjykata i ka vërtetuar disa fakte relevante. Dëshmitari ka qenë aktivist i organizimit paralel të institucioneve të Kosovës, të cilat institucione ishin ngritur nga shqiptarët etnik, pas suprimimit të autonomisë dhe kishte mbuluar një territor të caktuar në qytetin e Pejës të cilin dëshmitari e ka quajtur Bashkësia Lokale Rr., çka do të thotë se dëshmitari e ka njohur mirë terrenin dhe banorët e saj, pasi sikurse dëshmon dëshmitari kanë mbajtur shënime të cilat ishin në kuadër të punës së këtyre institucioneve paralele.

Dëshmia e dëshmitarit A. N. është shumë relevante për datën kritike me 28 Mars 1999 ngase i njëjti ka qenë dëshmitarë i drejtpërdrejtë i dhunës dhe terrorit të ushtruar mbi popullatën e lagjes “...” duke shtënë më armë automatike me qëllim të frikësimit të popullatës civile shqiptare, e të cilët janë nxjerrë dhunshëm nga shtëpitë e tyre dhe janë detyruar që të shkojnë në Malin e Zi. Dëshmitari ka përshkruar në hollësi ditën kritike duke dëshmuar se pas orës 12:00 i pandehuri Z. Dj. së bashku me një person të quajtur S. të cilin mbiemrin nuk ja din, një taksist dhe personin e katërt nuk e ka njohur, të armatosur me armë automatike Kallashnikov dhe me xhaketa ushtarake kamuflazhe, kanë shtënë në ajër me armë dhe i kanë dhënë afat pesë minuta që të largohen që të gjithë duke bërë titur “Shqiptarëve të gjithëve duhet me ju vra, shkoni në Shqipëri”. Ky dëshmitarë ka dëshmuar se të pandehurin Z. e ka njohur dhe se ai është më i ri se dëshmitari, por që kanë shkuar në të njëjtën shkollë “....”, ka dëshmuar se e kanë quajtur Z. shkurtimisht. Pra kjo dëshmie përveç që është e rëndësishme për ngjarjen në lagjen “” gjykata edhe në bazë të kësaj dëshmie ka vërtetuar disa çështje relevante, e ato janë; që i pandehuri në kohën e krimit ka qenë në qytetin e P. dhe jo në B. ashtu sikurse ka paraqitur alibin e tij, e cila alibi do të eleborohet më poshtë, i njëjti është parë nga dëshmitari A. N. i cili e ka njohur edhe më parë ngase kanë shkuar në të njëjtën shkollë, i pandehuri ka qenë i uniformuar dhe pjesëmarrës në krime të luftës, pra në fushatën e orkestruar për frikësimin, eliminimin dhe dëbimin e popullatës së pambrojtur civile shqiptare.

VII. Alibi i të pandehurit dhe analiza e mbrojtjes

7.1. I pandehuri Z. Dj. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. Lj. P. në të gjitha fazat e procedurës penale kundër të pandehurit kanë paraqitur alibinë, duke pretenduar se i pandehuri në kohën kur janë kryer këto krime ka qenë në B. të Republikës së Serbisë për studime. Gjykata lidhur me këtë rrethanë shumë të rëndësishme për çështjen panele ka dëgjuar disa dëshmitarë, sikurse ata të prokurorisë ashtu edhe ata të mbrojtjes.

7.2. Nga dëshmitë e dëshmitarëve F. Sh. dhe S. T., gjykata e ka vërtetuar faktin se i pandehuri Z. Dj. ka punuar si oficer i sigurimit të objekteve të Misionit Verifikues të OSCES-së në atë kohë

në Kosovë dhe sipas udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë F. Sh., i njëjti ka punuar nga mesi i Janarit të vitit 1999 deri me evakuimin e misionit e që ka qenë data 20 Mars 1999.

Të njëjtën gjë e konfirmon edhe dëshmitari S. T. i cili ka qenë supervizor i tij në punë në Misionin Verifikues të OSCE-së, pra e ka konfirmuar se i pandehuri ka punuar në këtë mision si oficer i sigurimit të objekteve dhe se nuk ka pasur mungesa në punë deri në evakuimin e misionit diku rreth datës 20 Mars. Dëshmitari T. edhe Sh. kanë dëshmuar lidhur me atë, se kanë pasur nja bashkëbisedim së bashku për Z., pasi kishin dalë zëra se i njëjti është pjesëtar i policisë dhe kishin qenë të brengosur për daljen e sekreteve të punës jashtë misionit. Po ashtu dëshmitari S.T. e kishte parë të pandehurin në qytetin e P. tre – katër ditë para ngjarjeve kritike, gjerë sa dëshmitari T. e kishte dërguar vajzën e tij tek mjeku, sipas dëshmitarit takimi me të nuk ishte miqësor por që në fund e kishte sugjeruar që ta marrë familjen dhe të largohet nga P., gjë që e kishte bërë dëshmitari.

Se i pandehuri ka punuar në Misionin Verifikues të OSCE-së e dëshmon edhe prova Kopja e ID kartelës së OSBE Misionit verifikues e periudhës 1998-1999, e cila është administruar në shqyrtimin gjyqësor si provë materiale.

Po ashtu dëshmitarja B. M. e cila ka jetuar në të njëjtin pallat me të pandehurin në atë kohë e ka konfirmuar se i pandehuri së bashku me familje ka qenë në banesën e tij dhe e ka parë atë tre deri katër ditë para se popullata shqiptare e këtyre pallateve të zhvendoset me dhune nga aty.

7.3. Në anën tjetër dëshmitarët e mbrojtjes S. M. dhe I. C. kanë dëshmuar në favor të alibisë së të pandehurit, se në kohën kur janë kryer krimet të cilat janë objekt i kësaj çështje penale i njëjti është gjendur në B.

Dëshmitarja S. M. ka dëshmuar se ka jetuar në P. “...” dhe se ka qenë fqinjë me familjen e të pandehurit, ka shkuar shpesh në shtëpinë e tyre dhe se e ka pasur shoqe motrën e Z., J. Ka dëshmuar se Z. e kishte takuar dhjetë ditë para bombardimeve të Natos gjersa kjo ishte me babin e saj Z. i kishte thënë se do të shkonte në B. sepse do të fillojnë bombardimet. Po ashtu ka dëshmuar se baba i saj i kishte thënë se shumë mirë që Z. ka shkuar në B. dhe një far forme i ka dhënë të drejtë se me të vërtetë filluan bombardimet ashtu sikurse ka pandeh Z. Më pas dëshmitarja e përshkruan një situatë kur ajo së bashku me motrën e Z. J. kishin shkuar në P. e P. për t'a telefonuar Z. në B., ngase linjat e telefonit nuk kanë punuar në shtëpi shkaku i bombardimeve.

Dëshmtari i mbrojtjes I. C., po ashtu ka dëshmuar në favor të alibisë së të pandehurit duke potencuar se me Z. kanë studiuar në universitetit “...” e i cili universitet kishte kaluar në B. si pasoj e luftës në Kosovë dhe ka përshkruar takimet e tij me të, në qytetin e B.

7.4. Gjykata i ka analizuar që të gjitha dëshmitë sa i përket alibisë së të pandehurit veç e veç dhe ne lidhmëni me njëra tjetrën. Gjykata e ka vërtetuar përtej çdo dyshimit faktin se i pandehuri ka lidhur marrëdhënie pune me Misionin Verifikues të OSCE-së, për çka flet edhe prova materiale ID kartela e tij e punës dhe se në bazë të udhëheqësve të tij në punë i njëjti nuk ka pasur mungesa ne punë deri në evakuimin e këtij misioni, që ka qenë data rreth 20 - 22 Mars 1999. Këto janë prova bindëse për gjykatën me të cilat vërtetohet e kundërta alibit të tij e cila është paraqitur që nga momenti i arrestimit të tij, por që rrugës gjatë zhvillimit të procedurës penale i pandehuri i ka ndërruar datat e kinse shkuarjes së tij në B. dhe këtë e ka bërë i shtyrë nga dëshmitë e dëshmitarëve të prokurorisë të cilët kanë qenë dëshmi bindëse, të argumentuara dhe që janë në logjikën e arsyeshme se si do të vepronte një njeri i punësuar i cili ka pasur obligime ne punë.

Përpyekjet e të pandehurit që shkuarjen e tij në Beograd t'a lidhë edhe me faktin se këtë e ka bërë që t'i shmanget përgjegjësisë së mobilizimit si pjesëtar rezervë i policisë, për gjykatën janë të pabesueshme për vet faktin se në vitin 1999 Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë ka ushtruar kontrollin e saj si në Serbi ashtu edhe në Kosovës dhe se në rrethanat e kohës largimi në Beograd nuk ka përbërë ndonjë rrethanë në bazë të së cilës mund të argumentohet se i njëjti do të mund t'i shmangej obligimit për tu mobilizuar.

Mbrojtja e të pandehurit lidhur me alibinë e tij është fillimisht e pa saktë sa i përket hapësirës kohore, pra ka pësuar ndryshime gjatë kohës, është jashtë logjikës, nuk mbështetet në prova materiale, edhe dëshmitë e dëshmitarëve S. M. dhe I. C. nuk janë të besueshme për gjykatën sepse nuk kanë mbështetje në asnjë provë tjetër, përkundrazi janë në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve F. Sh. dhe S. T. dhe B. M., por edhe janë në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve A. N. dhe të gjithë dëshmitarëve që e kanë identifikuar të pandehurin si pjesëmarrës në krim.

Mbrojtësi i të pandehurit Z. Dj. av. L. P. lidhur me alibinë ka cituar një pjesë të aktgjykimit të Gjykatës Ndërkombëtare Për Ish Jugosllavi në Hagë me nr.IT-98-32-A në rastin prokurori kundër M. V. ku në mes tjerave theksohet: *“kur i pandehuri thirret në alibi, ai nuk është i obliguar që t'a dëshmoj që alibi është i vërtetë. Barra e provës është në prokurorinë dhe gjithmonë mbetet në prokurorinë”*

Gjykata plotësisht pajtohet me këtë citat, sepse mbi prokurorinë bie barra provës dhe në rastin konkret prokuroria me provat e propozuar dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor, ka arritur ta dëshmoj të kundërt e alibisë së të pandehurit, apo me anë të provave është dëshmuar se alibi është e rrejshme dhe është bërë për t'ju shmangur përgjegjësisë penale. Pra argumentimi i të kundërtës së alibisë me anë të provave, për vendndodhje e të pandehurit në kohën kritike tregon për atë që quhet *mans rea* (mendja kriminale) e të pandehurit për të fshehur një rrethanë, ngase po të ishte ndryshe i pandehuri nuk kishte pse ta bënte sepse e vërteta është një dhe e vetme. Kuptohet se vetëm dëshmimi i rremë i alibisë lidhur me vendndodhjen në shumicën e rasteve nuk është i mjaftueshëm për ta shpallur një person përgjegjës, nuk është as në këtë rast, mirëpo edhe me provat tjera më të drejtpërdrejta është dëshmuar fajësia e të pandehurit.

7.5. Teoria e mbrojtjes e të pandehurit ka shkuar edhe në drejtimin e mohimit apo tentimit për zhvleftësimin e disa prova materiale si Deklarata e dëshmitarit Sh. K. e dhëne me dt. 05.06.2000 KMLDNJ, duke e vënë në pikëpyetje vendin e dhënies së saj, e që për gjykatën nuk ka asnjë dyshim e ajo është dhënë në P. me datën e cekur dhe jo në U. ashtu siç është pretenduar, sepse qyteti U. figuron në rubrikën se ku ka qenë i shpërngulur dëshmitari në kohën e luftës. Përmes kësaj prove materiale gjykata e vërtetoi faktin se i dëmtuari në këtë deklaratë ka identifikuar personin N. (V.) M. i lindur me 01.03.1964 i lindur në fshatin R. si personin që ka ndaluar dhe më pas ka vlarë S. Z. dhe B. B. duke e përshkruar si shtatshkurtër, i plotë, flokë të zeza të shkurtër, me fytyrë të rrumbullakët dhe të lyster me të zezë, me vetulla të zeza të theksuara, i uniformuar dhe i armatosur.

7.6. Në lidhje me provën materiale Kopja e listës së datës 03.06.1999 e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – Sekretariati në P. nga Komandanti i Stacionit Policor Major – M. S., nën numrin rendor një figuron emri Z. Dj. si pjesëtar i njësisë rezervë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe për të gjithë këta pjesëtarë është shënuar vetëm emri dhe mbiemri pa të dhëna të tjera. Po ashtu në bazë të këtij dokumenti figuron se i pandehuri është angazhuar me datë 21.04.1999. Teoria e mbrojtjes se në këtë rast kemi të bëjmë me një person tjetër të quajtur Z. Dj. nuk qëndron dhe është në kundërshtim me provën materiale të lexuar në shqyrtimin

gjyqësor; dëshmia e siguruar nga burimet e hapura që Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 1999 kishte publikuar pjesëtar policor të vrarë në vitin 1998 në Kosovë në adresën e internetit <https://arhiva.serbia-info.gov.rs/vesti/1999-02/19/9773.html> datë 19.02.1999 ku thuhet se; Z. Dj., i lindur me 07.09.1970 në Lc. Ai mbaroi shkollën e mesme metalike dhe një kurs për oficerët e policisë. Në MUP të Republikës së Serbisë që nga viti 1992, i martuar, vajza T. I vrarë më 9 gusht në një sulm terrorist në fshatin P, Komuna e D. Pra për gjykatën është e qartë se polici tjetër me emrin Z. Dj. në kohën e cila është objekt i kësaj akuza ka qenë i vrarë, ndërsa burimi nga ku është marrë ky informacion i takon burimeve të hapura dhe është shumë kredibil pasi është një adresë interneti qeveritare në Serbi dhe përgjithësisht këto teknika të hetimit janë të njohura dhe të pranueshme edhe sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës por edhe më gjerë. Në lidhje me datën 21.04.1999 të angazhimit të pandehurit Z. Dj. si pjesëtar i njësisë rezervë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, e cila datë figuron si e tillë në dokument, gjykata konstatuar se i pandehuri Z. Dj. kohë me parë ishte pajisur me pushkë automatike Kallashnikov e cila është pushkë për vrasje masive dhe se çështja e datës e cila figuron në dokument është për qëllime administrative dhe se nuk ka dyshim se i pandehuri ka qenë i angazhuar në terren që nga fillimi i bombardimeve të NATO mbi caqet serbe, pasi që edhe vet e ka pranuar se i është dhënë pushkë automatike nga mbrojtja territoriale.

7.7. Në lidhje me teorinë e mbrojtjes se i pandehuri Z. Dj., që nga koha e pasluftës e deri në vitin 2014 ka jetuar në Kosovës dhe ka punuar në shumë organizata ndërkombëtare dhe organizata vendore qeveritare dhe joqeveritare, për të cilat ka ofruar edhe prova shkresore dhe fotografi, e në të cilat organizata sipas mbrojtjes edhe është verifikuar e kaluara e tij kriminale. Tutje ka shtuar se personat që kanë kryer krime në Kosovë me kohë janë larguar. Lidhur me këto gjykata vlerëson se këto argumente si të tilla nuk tregojnë për veprimet e të pandehurit gjatë kohës së luftës. Fillimisht i pandehuri ka ikur pas luftës nga qyteti i tij i lindjes Peja dhe arsyet gjykata mund vetëm ti supozoj dhe nuk do të lëshohet në këto arsye. Po ashtu fakti se ka punuar në shumë organizata dhe se është verifikuar e kaluara kriminale e tij për gjykatën nuk është ndonjë fakt relevant, sepse po e marrim të mirëqenë se i pandehuri nuk paska figuruar me të kaluar kriminale, por krimet e luftës janë krime specifike që në ndonjë rast zbulohen pas shume e shume viteve, kjo është arsyeja edhe pse nuk parashkruhen, pra këto krime nuk i përkasin kriminalitetit ordiner ku ekzistojnë prova forenzike e balistike, sepse vetë gjendja e luftës dhe qëllimi për të fshehur këto krime e pamundësojnë një gjë të tillë, pra i pandehuri ka qenë i kujdesshëm në lëvizjet e tij gjatë kësaj periudhe dhe thjeshte ka pandehur se në grumbullin e forcave ushtarake të cilat kanë kryer krime ka mbetur i pavërejtur. Gjithmonë ekziston një moment nga ku fillon dhe zgjidhet një çështje penale, kjo ka ndodhur edhe në këtë rast, pra është dashur kohë që të kompletohet mozaiku i ngjarjes. Mbi këtë logjikë argumentohet edhe pse nuk gjendet emri i Z. Dj. në letër rreshtimin e ish Gjykatës së Qarkut në P. ku janë kërkuar 101 persona për krime të luftës.

Në anën tjetër edhe përfaqësuesi i palëve të dëmtuara av. K. K. ka prezantuar prova të cilat i ka marrë nga rrjeti social Facebook i të pandehurit, ku i pandehuri shprehet me tone raciste për popullatën shqiptare të Kosovës. Kjo në vetvete nuk është ndonjë provë e cila e lidhe drejtpërdrejtë të pandehurin me krimet e luftës, mirëpo këto prova tregojnë për orientimin ideologjik dhe politik të pandehurit i cili nuk dallon shumë nga koha e luftës në Kosovës dhe rrethanave politike të asaj kohe.

7.8. Mbrojtësi i të pandehurit Z. Dj. ka paraqitur vërejtjet dhe kundërshtimin e tij sa i përket kualifikimin juridik të veprës penale e cila i është vënë në barrë të pandehurit nga ana e prokurorisë, duke vlerësuar se prokuroria në mënyrë të gabuar e ka ngarkuar të pandehurin me dy vepra penale të Krimeve të luftës kundër popullatës civile, me të cilin kundërshtim gjykata pajtohet, sepse krimet e luftës si vepër penale mund të kryhen me shumë veprime inkriminuese,

por edhe të shtrihen një hark kohorë të ndryshëm, por që duhet të shqiptohet një dënim i vetëm bazuar në minimumin dhe maksimumin të bazuar me dispozitë ligjore, pra Krimet të luftës kundër popullatës civile është veprë e përbërë penale. Kualifikimi juridik i veprës penale ka të bëjë edhe me veprimin e ligjit në kohë, andaj gjykata ndaj të pandehurit ka aplikuar ligjin i cili ka qenë në kohën e kryerjes së veprës penale.

- XIII. Identifikimi i pandehurit

Në lidhje me identifikimin e të pandehurit janë ndërmarrë një mori e veprimeve procedurale të parapara me ligj.

8.1. Dëshmitari Sh. K. në Procesverbalin Mbi Identifikimin e Personit Përmes Fotografisë numër rasti PPS.nr.456/2009 datë 19.07.2018 e bërë në Stacionin Policorë në P. ka bërë përshkrimin e personi duke përshkruar si person të shkurtër. Më pas ky dëshmitarë në mesin e dhjetë fotove të prezantuara ka vënë nënshkrimin e tij tek foto me numër 3, pra foto e Z. Dj. duke shtuar se personi në foton nr. 3 po me përngjanë me personin që ka vlarë S. dhe Ba.

Sa i përket identifikimit përmes fotografive nga dëshmitari Sh. K. të bërë në Stacionin Policorë në P. me datë 24.03.2016, ky identifikim është bërë konform rregullave procedurale dhe i njëjti e ka identifikuar të pandehurin si pjesëmarrës në krim duke thënë se ky person është ai që ka ndaluar dhe vlarë S. dhe B., ndërsa në deklaratën e dhënë me dt. 05.06.2000 KMLDNJ, në procesverbalin e kësaj deklarate thuhet se dëshmitari ka identifikuar pësonin N. (V.) M. i lindur me datë 01.03.1964 si personin që kishte ndaluar S. Z. dhe B. B. duke e përshkruar atë person si shtatshkurtër, i plotë, flokë të zeza të shkurtër, me fytyrë të rrumbullakët dhe vetulla të zeza të theksuara. Pra ekzistojnë mos përputhmëni në identifikim, por edhe në përshkrim të personit që i ka ndaluar e më pas vlarë S. dhe B. Ky përshkrim nuk i përgjigjet karakteristikave fizike të pandehurit. Këto mos përputhje kanë eksituar edhe lidhur me moshën e personit që ka bërë ekzekutimin.

Është fakt se ky dëshmitarë ka identifikuar dy pasona edhe atë N. M. ne vitin 2000 edhe të pandehurin në vitin 2016. Gjykata nuk është në njohuri nëse gjatë vitit 2000 në mesin e fotografive të prezantuara ka qenë edhe fotografia e të pandehurit Z. Dj., dhe nëse në atë kohë do të kishte qenë në gjendje ta identifikoj atë. Ajo që është e sigurt është se në vitin 2016 dëshmitari e ka identifikuar të pandehurin si pjesëmarrës në krim. Gjykata ka parasysh se i pandehuri ka qenë përjetues i ngjarjeve traumatike të intensitetit të lartë pasi që para syve të tij janë vlarë katër persona, ndërsa dëshmitari ka qenë i rrahur në mënyrë brutale dhe ka qenë në prag të eliminimit fizik pasi që i ishin drejtuar tytat e automatikut. Ne rrjedhën e ngjarjeve që janë zhvilluar ditën kritike të cilat kanë qenë të intenzitetit të lartë është shumë e qartë se ky dëshmitarë i ekspozuar kaq shume dhunës dhe terrorit nga forcat serbe, nuk ka mundur që t'i memorizoj në detaje situatat dhe fytyrat. Bazuar ne këto mos përputhmëni në mungesë edhe të dëshmitarëve tjerë që e kanë parë ekzekutimin e S. dhe B., gjykata nuk ka gjetur se ekzekutuesi i tyre i drejtpërdrejtë ka qenë Z. Dj., kjo edhe për faktin se në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve gjykata ka arritur tek përfundimi se personi që ka ekzekutuar S. dhe B. ka qenë i stacionuar tek shtëpia e A. M., pra ai ishte duke i prituri kolonën e personave të cilët ushtarët e tjerë po i dëbonin me dhunë. Pra kjo rrethanë nuk përputhet me dëshminë e dëshmitarëve të cilët kanë dëshmuar se i pandehuri i ka dëbuar nga shtëpia, ose në rastin e V. i ka marrë vëllan dhe pasi që i ka qitur dhunshëm në rrugë, i ka urdhëruar që të ngjiten lart në drejtim të shtëpisë së A. M.

8.2. Dëshmitarja V. B. në Procesverbalin Mbi Identifikimin e Personit Përmes Fotografisë numër rasti PPP.nr.31/2017 datë 25.02.2019 e bërë në Stacionin Policorë në P. ka bërë përshkrimin e

personi duke përshkruar; të parin paramilitarë serb që ka parë ditën kritike me datë 29.03.1999 ka parë në afërsi të shtëpisë së saj ka qenë më gjatësi 1.70 cm me sy të gjelbër me shëndet mesatar, i moshës tridhjetë vjeçar. Ndërsa personi i dytë ishte më i ri dhe më i dobët nga shëndeti. Më pas kjo dëshmitare në mesin e dhjetë fotografive të prezantuara ka nënshkruar tek fotografia me numër një në të cilën gjendej Z. Dj. dhe foton me numër dhjetë ku gjendej N. J.

8.3.Dëshmitari M. Xh. në Procesverbalin Mbi Identifikimin e Personit Përmes Fotografisë numër rasti PPP.nr.31/2017 datë 26.02.2019 e bërë në Stacionin Policorë në P. ka bërë përshkrimin e personi duke përshkruar; ushtari i parë ka qenë i gjatë rreth 185 cm i shëndetshëm dhe mosha e tij ishte rreth 30-35 vjet. Ushtari i dytë ishte rreth moshës 27 – 30 vjeçare me gjatësi 1.80 cm, mesatar nga shëndeti, ishte me sy të gjelbër dhe nga pamja ishte bjond. Më pas ky dëshmitarë në mesin e dhjetë ftove të prezantuara ka vënë nënshkrimin e tij tek foto me numër tre, pra foto e Z. Dj. duke shtuar se personi në foton nr. 3 është i njëjti që ditën kritike është ballafaquar me atë dhe i njëjti nuk ia ka marrë paratë.

8.4.Në fillim lidhur me identifikim e personit përmes fotografisë gjykata konstatoi se ky identifikim është bërë konfrom dispozitës së nenit 120 të KPPRK-së, që është dispozitë specifike që e rregullon identifikimin e personit apo sendeve dhe në asnjërin nga paragrafët e nenit të cekur nuk kërkohet prania e obligueshme e avokatit mbrojtës. Mbrojta e të pandehurit në mënyrë të gabuar është referuar në dispozitën e nenit 61 par.3 e cila përcakton: *mbrojtësi ka të drejtë të njoftohet me kohë për vendin dhe kohën e zbatimit të veprimeve hetimor, të marrë pjesë në to dhe ti shikoj shkresat dhe provat e çështjes në pajtim me dispozitat e këtij kodi*. Pra kjo është një dispozitë e përgjithshme, ku në pjesën e fundit përcaktohet se këtë të drejtë e ka në pajtim me dispozitat e kodit, çka do të thotë se vetëm në rastet kur është e përcaktuar shprehimisht më dispozitë konkrete mbrojtësi e gëzon të drejtë, psh, ashtu siç është përcaktuar në dispozitën e nenit 132 par.5 të KPPRK-së gjatë marrjes së deklaratës në procedurë paraprake, ndërsa neni 120 i KPPRK-së, nuk e përcakton një obligim të tillë.

8.5.Dëshmitari A. N. në seancën e datës 09.07.2020 gjatë dhënies së dëshmisë së tij, pasi që ka dhënë shumë informata lidhur me të pandehurin, duke dëshmuar se kanë qenë në të njëjtën shkollë dhe se e ka njohur shumë kohë me parë, duke dhënë detaje edhe për kafiteritë ku ka punuar i pandehuri si kamerier, e ka identifikuar në sallën e gjyqit të pandehurin si pjesëmarrës në krimet me dt.28 Mars të vitit 1999 në lagjen “....”

8.6.Edhe dëshmitari F. H. gjatë dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 18.06.2020 ka dëshmuar se me të dëgjuar për arrestimin e të pandehurit me emër Z. Dj. ka kërkuar këtë emër në Facebook, dhe në mesin e disa personave me të njëjtin emër ka identifikuar të pandehurin si personin që ka gjuajtur atë dhe dajën e tij më pushkë automatike.

8.7. Dëshmitarët e drejtpërdrejtë si V. B., M. Xh. e kanë identifikuar të pandehurin përmes fotografive dhe atë në mënyrën e paraparë me ligj. Këta dëshmitarë nuk kanë pasur mëdyshje lidhur me identifikimin, kanë bërë përshkrim të saktë të karakteristikave fizike të pandehurit duke dhënë edhe shpjegime se në çfarë rrethana janë takuar dhe komunikimin e që e kanë pasur me të pandehurin ditën e krimit. Dëshmitarja V. B. e ka identifikuar si ushtarin që ia ka marrë vëllaun, ndërsa M. Xh. e ka identifikuar si ushtari i cili nuk ia ka marrë paratë.

Po ashtu edhe dëshmitarët A. N. dhe F. H. e kanë identifikuar qartë të pandehurin dhe kanë treguar se në bazë të cilave karakteristika e kanë dalluar, si flokët dhe sytë, e që të ky i pandehur këto ty tipare fizike janë karakteristike dhe që bien ne sy, e që e bëjnë jo relevante ngjyrosjen e fytyrës në pjese të caktuara të saj.

8.8. Në bazë të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor, është vërtetuar gjendja e fakteve sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Se i pandehuri ka paraqitur alibinë e rreme është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar, sepse me dëshmitë e dëshmitarëve të lartcekur është vërtetuar e kundërta, pra këta janë persona që ditën kritike kanë qenë viktime të dhunës të ushtruar nga i pandehuri. Alibin e të pandehurit përfundimisht e hedhin poshtë dëshmitë e F. Sh. dhe S. T., ku i pandehuri kishte punuar me këta në misionin vëzhgues të OSCE-së dhe në bazë të dëshmive të këtyre dëshmitarëve është vërtetuar fakti se i pandehuri ka qenë në punë deri ne evakuimin e këtij misioni, që ka ndodhe mes datave 20-22 mars 1999. Prezencën e të pandehurit në Pejë në atë kohë e konfirmon edhe fqinja e tij B. M. Shtrohet pyetja pse i pandehuri ka paraqitur një alibi të tillë e cila është larg me realitetin.

Se i pandehuri ka qenë pjesëtar i policisë rezervë e dëshmon prova materiale kopja e listës së datës 03.06.1999 e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – Sekretariati në P. nga Komandanti i Stacionit Policor Major – M. S. Ndërsa se nuk kemi të bëjmë me një person tjetër me emër dhe mbiemër të njëjtë e vërteton prova materiale dëshmia e siguruar nga burimet e hapura që Ministria e Punëve të brendshme në vitin 1999 kishte publikuar pjesëtar policor të vrarë në vitin 1998 në Kosovë.

Në bazë të dëshmive të dëshmitarëve është vërtetuar se pas fillimit të bombardimeve të NATO mbi caqet ushtarake, paraushtarake dhe policore Serbe, kishte filluar një fushate e orkestruar e spastrimit etnik në qytetin e P., duke e dëbuar dhunshëm popullatën civile shqiptare të paarmatosur nga shtëpitë e tyre, duke plaçkitur pasurinë e tyre, duke cenuar integritetin trupor, duke djegur shtëpitë e tyre dhe duke vrarë civil, ashtu siç e patën fatin edhe H. Z., S. Z., B. B. dhe R. M. Në këto aksione kishin marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i forcave serbe të cilët nuk kishin qenë të uniformuar njëjtë, pra kishte dallime në mes tyre, ku disa nga ta kishin edhe pjesë të rrobave civile. Pjesëtar të caktuar të këtyre forcave kishin hyrë për të dëbuar popullatën civile shqiptare duke aplikuar masat e frikësimit dhe terrorit mbi ta, siç është rasti i familjes B., ku i pandehuri kishte hyrë në oborrin e shtëpisë së kësaj familje dhe ishte nxjerrë në turmën e njerëzve të cilëve i ishte urdhëruar që të niseshin në drejtimin e caktuar, e që kjo popullatë civile shqiptare fillimisht nuk e kanë ditur se për ku i kishin drejtuar dhe vetëm ata që shpëtuan të gjallë të gjithë u dëbuan ne Malin e Zi. V. B. është dëshmitare e drejtpërdrejtë e cila e ka identifikuar të pandehurin si personin që ia ka marrë nga shtëpia vëllanë e ekzekutuar dhe atë e ka bërë qartë përmes tipareve të tij dalluese.

Njëjtë edhe dëshmitarët M. Xh. dhe i cili kishte pasur kontakt ditën kritike me të pandehurin Z., e ka dalluar atë dhe e ka përshkruar si person i cili kishte marrë pjesë në aksion të dëbimit e terrorizimit të popullatës civile shqiptare dhe si personin i cili nuk ia ka marrë paratë

Se i pandehuri ishte pjesëtar i këtyre forcave që në shenjë hakmarrje për bombardimet e NATO kudër caqeve ushtarake serbe kryen këto krime në qytetin e P., flet edhe dëshmitari A. N. i cili ka qenë viktimë e dhunës të ushtruar me datë 28.03.1999 në lagjen “.....”, i cili me saktësi e ka identifikuar të pandehurin Z. Dj. të cilin e ka njohur dhe ka treguar për metodat të cilat i kanë përdorë ky formacion, për të terrorizuar popullatën shqiptare, e të cilat metoda i kanë vazhduar në lagjen “.....” një ditë më vonë, ku dëshmitari F. H. e saktësi e ka dëgjuar komunikimin me radiolidhje në mes ushtarëve duke u përmendur emri “.....” nga ku e ka kuptuar se personi që kishte shtënë në atë dhe dajën e tij, e i cili person ishte vënë në kërkim të tyre dhe kishte hyrë në oborrin e shtëpisë së tij e quanin shkurtimisht “.....” dhe kishte qenë në gjendje që ta shoh nga

dërrasat e kulmit të shtëpisë. Se të pandehurin e kanë thirrur shkurtimisht Z. e ka vërtetuar edhe dëshmitari A. N.

Gjykata bazën e këtij aktgjykimi e ka bazuar në faktet dhe provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, duke vlerësuar me ndërgjegje çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, duke vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse dhe ka nxjerr përfundimin se me këto prova është vërtetuar pa mëdyshje se i pandehuri Z. Dj. në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Krime të Luftës kundër popullatës civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, lidhur me nenin 3 të përbashkët për Konventat e Gjenevës të dt.12 Gusht 1949 dhe nenin 4 të Protokollit 2 të datës 8 Qershor të dt.1977 shtojcë e Konventave të Gjenevës.

- IX. Vendimi mbi dënimin

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 41 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësinë e dënimit, ku me këtë rast si rrethana lehtësuese gjykata pati parasysh faktin se nuk ka të dhëna se në të kaluarën i pandehuri Z. Dj. ka kryer vepra penale, ndërsa rrethana rënduese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të pandehurit Z. Dj. në kryerjen e veprës penale dhe shkallën e lartë të cenimit të drejtës së mbrojtur.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale të kryer, duke qenë e bindur se me dënimin si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale, dhe ky dënim të ndikoj te të pandehurit që të përmbahet nga përsëritja e veprave penale në të ardhmen, po ashtu të arrihet edhe qëllimi ndëshkimorë në kuptim të preventives gjenerale, që dënimi i shqiptuar të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarve për dëmet e shkaktuara nga vepra penale, por edhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit, dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nen. 454 par.1. të KPPK-së.

Të dëmtuarit: L. Z., M. Z., V. B., Sh. K., M. Xh., F. H., F. M., A. N., L. H. konform nenit 463 par.2 të KPPK-së për realizimin e kërkesës pasurore – juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil, ngase provat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykimin e plotë apo të pjesshëm të kësaj kërkesë.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI SPECIAL
PS.nr. 15/19 të dt.08.04.2021

Sekretarja juridike:
Shqipe Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.